



MANUAL TRAJNIMI

DHUNA TEK FËMIJËT DHE TË RINJTË,
NDIKIMI I RRJETEVE SOCIALE
NE GJENERIMIN E SAJ

*Për mësuesit dhe Profesionistët
e Shërbimeve psiko-sociale në shkolla*





DHUNA TEK FËMIJËT DHE TË RINJTË, NDIKIMI I RRJETEVE SOCIALE NE GJENERIMIN E SAJ

MANUAL TRAJNIMI

Për mësuesit dhe Profesionistët
e Shërbimeve psiko-sociale në shkolla



Punoi: Livia Nano, psikologe
Fjorda Dragoti, psikologe

Ndihmoi: Anita Pilika, mjeke psikiatre

Manuali i trajnimit është zhvilluar me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor" të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA). Përmbajtja e manualit është përgjegjësi e vetme e Qendra Fokus si zbatuese e projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA).

PËRKUFIZIM

Ekzistojnë disa përkufizime për sa i përket dhunës ndaj fëmijëve.



1

Përdorim të qëllimshëm të forcës fizike ose të fuqisë, të kërcënimit ose të përdorimit të saj real, kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi a komuniteti, forcë e cila çon ose ka mundësi të çojë në plagosje, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose privim (OBSH).

2

Dhuna ndaj fëmijëve përfshin të gjitha format e dhunës fizike ose psikologjike, lëndimin dhe abuzimin, neglizhencën ose trajtimin neglizhues, keqtrajtimin ose shfrytëzimin përfshirë dhe abuzimin seksual sipas nenit 19 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

3

“Një fëmijë nën 18 vjeç konsiderohet i abuzuar nga prindi, kujdestari apo i rrituri n.q.s. ai ose ajo trajtohet në një mënyrë të papranueshme në një kohë dhe një kulturë te caktuar”.

4

Një fëmijë i abuzuar apo i neglizhuar është personi i cili është dëmtuar apo kërcënuar, mendërisht apo fizikisht nga veprimet ose mungesa e veprimeve të personave përgjegjës për kujdesin ndaj tij.

5

Abuzim i fëmijës, nënkupton çdo veprim apo mosveprim, i qëllimshëm apo me paramendim, i kryer nga prindi, kujdestari, personi i besueshëm apo ndonjë person tjetër.

Në çdo shoqëri sjellja e prindërve dhe e të rriturve ndaj fëmijëve përcaktohet nga ligjet në fuqi, nga kodi moral mbizotërues i shoqërisë, si dhe normat e sjelljet që ajo shoqëri respekton. Në këtë sfond përcaktohen dhe kufijtë e një sjelljeje shoqërisht të pranueshme apo jo ndaj fëmijëve. Këto sjellje dallojnë nga një shoqëri në tjetrën, nga një komb tek tjetri dhe madje dhe brenda një kombi. Për këtë arsye është e vështirë të jepet një prevalencë dhe incidencë intencionale mbi abuzimin. Askush nuk mund të thotë egzaktesisht pse te rriturit përdorin autoritetin e tyre në këtë mënyrë ndaj fëmijëve.

STATISTIKA

Për vitin 2018 sipas të dhënave të marra nga publikimet e UNICEF, numri i femijeve që kanë raportuar dhunë nga institucionet arsimore ka qenë si më poshtë:

12%

e fëmijëve janë viktime të ngacmimeve seksuale

Lloji i dhunës	Numri	Viti
Dhune fizike	548	2018
Dhunë seksuale	3	2018
Dhunë emocionale	1433	2018
Neglizhim	358	2018



Numri i fëmijëve të trajtuar me Urdhër Mbrojtje në Gjykatë si viktime të dhunës në familje për vitin 2021 ka qenë 612 (288 meshkuj dhe 324 femra).

Sipas një studimi të BECAN-it (Studimi Epidemiologjik Ballkanik mbi Abuzimin dhe Neglizhimin e Fëmijëve), në Shqipëri rreth 12% e fëmijëve janë viktime të ngacmimeve seksuale dhe rreth 5% e tyre janë viktime të abuzimit seksual. Të dhënat nga Sistemi Kombëtar i të Dhënave për Abuzimin dhe Neglizhimin e Fëmijëve (NCANDS) të Qeverisë Amerikane tregojnë se më shumë se 3.1 milionë raste të abuzimit ose neglizhencës së fëmijëve janë hetuar në vitin 2020, nga 3.4 milionë në vitin 2019. Hetimet që rezultuan në gjetjen e abuzimit gjithashtu ranë nga 656,000 në 2019 në 618,000 në 2020.

Nga hetimet u zbulua se:



ishin viktima të neglizhimit



janë dhunuar fizikisht



janë abuzuar seksualisht



ishin viktima të trafikimit seksual

1,750 fëmijë vdiqën nga abuzimi ose neglizhenca në 2020.

Kjo ishte gjithashtu një rënie nga 1,830 që vdiqën në 2019.

Pandemia ndryshoi situatat familjare në shumë mënyra.

Ndërsa më shumë se 55 milionë studentë kaluan në mësimin virtual, kjo metodë mësimdhënie e bëri më të vështirë për mësuesit të identifikonin abuzimet e mundshme. Edukatorët janë shpesh të parët që zbulojnë dhe raportojnë problemet e mundshme.

Një rishikim i pavarur i të dhënave, i publikuar në Journal of American Medicine (JAMA), ofron një kontekst shtesë. Ky rishikim shqyrtoi raportet e mirëqenies së fëmijëve, vizitat në dhomën e urgjencës dhe shtrimet në spital gjatë pandemisë. Studiuesit vunë re një rënie në vizitat në ER dhe në raportim. Numri i shtrimeve në spital ka mbetur relativisht konsistent me vitet e mëparshme.

Pavarësisht rritjes së rreziqeve për shkak të stresorëve pandemikë, raporti i dhjetorit JAMA 2021 arrin në përfundimin se të dhënat mund të tregojnë se ndihma e qeverisë për familjet, rritja e pranisë së prindërve në shtëpi dhe bashkëpunimi midis prindërve dhe nxënësve në detyrat e shkollës mund të kenë luajtur një rol proaktiv në ndërtimin e lidhjeve më të forta dhe në zbutjen e disa abuzimeve dhe neglizhencës.

Megjithatë, studime të tjera tregojnë rezultate krejtësisht të ndryshme.

Studiuesit që shqyrtojnë të dhënat nga 39,000 fëmijë të



Mite për dhunën ndaj fëmijëve

MITE

FAKTE

Abuzuesit janë të panjohur për fëmijën

Ata që abuzojnë me fëmijët janë persona të besuar/ të afërt për ta: prindër, kushërinj, mësues, miq të ngushtë të familjes.

Të folurit rreth abuzimit seksual i tremb fëmijët, është më mirë të heshtësh

Të folurit rreth abuzimit seksual i mëson fëmijët për mekanizmat vetëmbrojtjës dhe të dinë ku të kërkojnë ndihmë

Vetëm vajzat e vogla të bukura janë pre e abuzimit seksual

Të dhënat tregojnë se viktimat e abuzimit seksual janë fëmijë të pambrojtur qofshin vajza, qofshin djem.

Fëmija im do të tregonte nëse do t'i ndodhte diçka

Një nga shenjat e abuzimit është izolimi dhe mungesa e dëshirës për të folur për sa ka ndodhur

Abuzimi seksual është një çështje e familjes dhe duhet trajtuar brenda familjes

Studimet provojnë se një fëmijë i abuzuar që nuk merr shërbimet për të cilat ka nevojë në kohën e duhur ka më shumë gjasa të vuajë pasojat në një kohë më të gjatë

Abuzimi seksual nuk mund të ndodhë kurrë në familjen time

Studimet tregojnë se abuzuesit e fëmijëve janë persona brenda rrethit të besimit dhe ai mund të ndodhë kudo

SINDROME TË KEQTRAJTIMIT TË FËMIJËVË

I- Sindromi i bebes së shkundur

Dëmtimet jo aksidentale të thella të kokës të njohura si SINDROMI I BEBES SE SHKUNDUR janë përshkruar nga John Caffey një radiolog. Mjeku vërejti lidhjen midis hematomës subdurale në fëmijët me fraktura të gjata të kockave të kokës, por jo me histori të traumave të kokës.

SINDROMI I BEBES SE SHKUNDUR ze 10-20% e të gjitha rasteve të abuzimit fizik dhe 75% e vdekjeve inflicide tek fëmijët. Ne duhet ta njohim këtë sindrom pasi është toksik:

20-40% e të sapolindurve vdesin, ndërsa 90 % e të mbijetuarve më vonë kanë probleme të të mësuarit dhe të sjelljes. Disa raste janë shpesh dhe me deficiente neurologjike, të cilat evidentohen më vonë.

Sindromi I bebes së shkundur është një term i përdorur për të përshkruar forcën e shkundjes dhe dëmtimet rezultuese nga shkundja.

Shpesh nuk ka shenja të jashtme të dëmtimit të fëmijës, por ka një dëmtim të brendshëm sidomos në kokë ose mbrapa syve.

Dëmtimet mund të përfshijnë:

- 1- Dëmtimin e trurit.
- 2- Hemoragji subdurale.
- 3- Prapambetje mendore, zhvillim të vonuar.
- 4- Shurdhësi, verbim, paraliza, vështirësi në të folur e në të mësuar.
- 5- Vdekje.

Termi SINDROMI I BEBES SE SHKUNDUR është diskutuar në literaturën mjekësore në 1972, por njohuritë rreth sindromës vazhdojnë të zhvillohen.

Shkundja violente është e rrezikshme tek te

porsalindurit dhe tek fëmijët e vegjël, sepse muskulatura e qafës së tyre është e pazhvilluar dhe strukturat e trurit janë fraxhile. Shkundja mund të dëmtojë trurin në disa drejtime. Pjesë të ndryshme të trurit mund të dëmtohen dhe të mos kryejnë funksionin e tyre

normal, mund të dëmtohen qelizat trunore dhe të ketë gjakrrjedhje. Kur fëmija është shkundur në moment zemërimi dhe frustracioni forca është 5-10 herë më e madhe se në rastet kur fëmija thjesht është goditur dhe vlarë.

Në qoftë se fëmija mbijeton, fatura mjekësore është tepër e lartë. Fëmija do të kërkojë trajtim mjekësor për dëmtimet e thella të trurit. Fëmija mund të institucionalizohet, ose ti nënshtrohet tipeve të tjera të kujdesit afat gjatë.

Në disa raste prindërit nuk e mendojnë se sa seriozisht kjo sjellje mund të dëmtojë një fëmijë të vogël, p.sh. të luajturit keq, apo goditja me forcë në kurriz.

Megjithatë kush kujdeset për fëmijët e vegjël - prindërit, bebies-sitters, profesionistët e kujdesit për fëmijë dhe të tjerë, duhet të mbajnë mend kurrë të mos shkundin bebet e vogla. Ekzistojnë komunitete lokale që mund të ofrojnë ndihmë për prindërit që kane fëmijë të vegjël që qajnë shumë, apo që mund t'iu duhet më tepër ndihmë dhe aftësi kopjuese.

Informacioni rreth SINDROMI I BEBES SE SHKUNDUR nuk jepet me tendencën për ti frikësuar prindërit të prekin fëmijët e tyre. Ky është për ti kujtuar prindërit që fëmijët e vegjël veçanërisht poshtë moshës 3 vjeç, kurrë nuk duhen shkundur për asnjë arsye.

SINDROMI I BEBES SE SHKUNDUR mund të shkaktohet kur fëmijët shkunden me forcë, kjo si pjesë e abuzimit, ose sepse një adult, ose kujdestar i ri momentalisht është frustruar nga të qarat e bebes. SINDROMI I BEBES SE SHKUNDUR mund të ketë konsekuenca shkatëruese për familjen, viktimën dhe shoqërinë.

SINDROMI MYNHAUZEN

Sindromi Mynhauzen është formë e abuzimit të fëmijës ku një prind (zakonisht nena, ne 99 % te rasteve) shpik sëmundje në mënyrë të qëllimshme për fëmijën e saj dhe e paraqit shpesh fëmijën në qendrat mjekësore, duke insistuar para personelit mjekësor se femija eshte shume i/e semure.

Viktimat fëmijë të këtij sindromi janë në rrezik për dëmtime serioze apo vdekje.

Sindromi Mynhauzen ndodh kur:

- Sëmundja në një fëmijë është stimuluar apo trilluar nga një prind apo kujdestar tjetër, apo të dy bashkë.
- Paraqitja e fëmijës për vlerësim dhe kujdes mjekësor, duke rezultuar në ekzaminime të shumëfishta mjekësore.
- Mohimi i dijenisë nga prindi të shkaqeve të mundshme të sëmundjes së fëmijës.
- Zhdukja e simptomave apo shenjave akute kur fëmija ndahet nga prindi.

Në mënyrë tipike por jo gjithmonë, harxhon shumë kohë në pavionin e spitalit dhe shfaq një familjaritet të dukshëm me termino-logjinë mjekësore. Ajo mund të jetë “miqë-sore” me stafin spitalor megjithëqë mund të krijojë pakënaqësi me sëmundjen kronike të fëmijës së saj dhe zemërim me punën e papërshtatshme të stafit mjekësor në ndjekjen e problemeve të fëmijës së saj. Ajo mund të insistojë që është “e vetmja” për të cilën fëmija do të hajë, pijë apo do të gëlltitë ilaçe.

Investigimi

Një ekip multidisiplinar i mbrojtjes së fëmijëve duhet të merret me nënën menjëherë. Ekipi duhet të ketë personel mjekësor, infermiere të kujdesit primar, përfaqësues nga Shërbimet sociale të vendit, profesionistë të shëndetit mendor dhe një mjek epidemiolog (person që është i specializuar në gjetjen e shkakut të sëmundjes).

Ky ekip do të përcaktojë n.q.s. konditat mjekësore të fëmijës i atribuohen Sindromit Mynhauzen, dhe informon personat kompetente të cilët punojnë në institucionet shtetërore, për të larguar fëmijën nga kujdesi i ekzekutorit dhe ndoshta për procedim penal. Personeli i policisë dhe ai i ligjit do të ndërhyjë që në fillim. Grumbullimi i të dhënave, arresti i përkohshëm, dhe përgatitja e rastit për hetuesi janë disa nga rolet e tyre.

Tabela paraqet disa nga simptomat mjekësore sëmundjen që shfaqin fëmijët që janë viktima të Sindromit Mynhauzen, së bashku me strategjitë e ekzekutorëve.

Prezantimi i zakonshëm i sindromit Mynhauzen nga i ndërmjetmi dhe metodat e zakonshme të mashtrimit	
Prezantimi	Mekanizmi
Apnea (ndalim i frymëmarrjes)	Mbytje, droga, helmim, gënjeshtër
Atake epileptike	Gënjeshtër, droga, helme, asfiksion
Hemorragji	I shton gjak urinës, të vjellave, etj.; rrugë intravenoze e hapur
Ethe, infeksion gjaku	Injeksion i feçeve, pështymës, ujit të ndotur tek fëmija
Të vjella	Helmim me droga që japin të vjella; gënjeshtër
Diarreja	Helmim me laksativë, kripëra, vaj mineral

Të ekzaminohen rregjistrat

- Rregjistrat e spitalit për atë fëmijë. Ato mund të jenë shumë voluminozë kështu duhet të pregatitet përmbledhja dhe analiza e tyre për përdorim të gjurmuesve. Rregjistrat mjekësorë duhet të shihen nga mjekët që të mos keqinterpretohen.
- Rregjistrat mjekësorë nga institucionet e tjera (preferohen origjinalët).
- Historia e edukatës dhe punës së prindërve.

Si pjesë e gjurmimeve do të jetë edhe një intervistë me infermierën e kujdesit primar në spital, sepse ky person është shpesh ai që ka harxhuar shumë kohë me fëmijën edhe me prindërit gjatë shtrimeve të shumta në spital. Ky person dhe të tjerët e intervistuar mund të mos jenë përkrahës të mundësisë të Sindromit Mynhauzen, apo mund ta mohojnë atë me zjarr, duke ngulur këmbë në kujdesin e mirë të nënës për



Kujdes!

Gjurmuesit kurrë nuk duhet ti tregojnë informacionin për njeriun që intervistojnë. Pediatri, ose ekipi multidisciplinar si një trup i vetëm duhet ta bëjnë diagnozën përfundimtare të Sindromit Mynhauzen, të bazuar mbi faktet, duke parë mospërputhjet e tyre me tregimet e së ëmës dhe përcaktimin që këto mospërputhje janë rezultat i keqkuptimit, pamundësisë apo fabrikimit.



Disa nga faktorët që gjenerojnë dhunë

Një nga faktorët që ndikon në ushtrimin e dhunës nga nxënësit është ekspozimi direkt ndaj dhunës qoftë edhe përmes video-lojërave apo televizionit. Një faktor tjetër i rëndësishëm i cili e nxit dhunën nëpër shkolla, është toleranca shoqërore ndaj fenomenit të dhunës. Mbetemi ende shoqëri tradicionale, e cila bazohet në zgjidhjen e problemeve përmes forcës.

Burim i dhunës dhe konfliktit janë armiqësitë, grindjet, shpërthimet e zemërimit, pakënaqësitë, xhelozia e tepruar, humbja e kontrollit të emocioneve, rrahjet, keqkuptimet, keqtrajtimet fizike, mosdurimi, e të tjera.

Ndikimi i rrjeteve sociale

Në vitin 2019, mbi gjysma e popullsisë së botës përdorën internetin. Përqindja më e madhe e përdoruesve të internetit janë persona nën 44 vjeç, me përdorimin e internetit në mënyrë të barabartë mes moshave 16-24 vjeç dhe 35-44 vjeç. Në nivelin global, një në tre përdorues të Internetit është një fëmijë (0–18 vjeç) dhe UNICEF vlerëson se 71 përqind e të rinjve janë tashmë në internet. Përhapja e pikave të hyrjes në internet, teknologjia mobile dhe grupi në rritje i pajisjeve të mundësuar nga interneti, të kombinuara me burimet e mëdha që mund të gjenden në hapësirën kibernetike, ofrojnë mundësi të papara për të mësuar, ndarë dhe komunikuar. Përfitimet e përdorimit të TIK përfshijnë qasje më të gjerë në informacion mbi shërbimet sociale, burimet arsimore dhe këshillat shëndetëso-re. Ndërsa fëmijët, të rinjtë dhe familjet përdorin internetin dhe celularët për të kërkuar informacion dhe ndihmë dhe për të raportuar incidente abuzimi, këto teknologji mund të ndihmojnë në mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga dhuna dhe shfrytëzimi. Ofruesit e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve gjithashtu përdorin TIK për të mbledhur dhe transmetuar të dhëna, duke lehtësuar kështu

regjistrimin e lindjeve, menaxhimin e rasteve, gjurmimin e familjes, mbledhjen e të dhënave dhe hartëzimin e dhunës, ndër të tjera. (OECD, “New Technologies and 21st Century Children: Recent Trends and Outcomes”, Education Working Paper No. 179).

Pavarësisht nga përfitimet e thella të internetit, fëmijët dhe të rinjtë mund të hasin një numër rreziqesh kur përdorin TIK. Ata mund të ekspozohen ndaj përmbajtjes së papërshtatshme për moshën ose kontakteve të papërshtatshme, duke përfshirë kryerësit e mundshëm të abuzimit seksual. Ata gjithashtu përballen me rreziqe që lidhen me privatësinë në internet që rrjedhin nga mbledhja e të dhënave, dhe mbledhja dhe përdorimi i informacionit për vendndodhjen. Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, e cila është traktati ndërkombëtar i të drejtave të njeriut ratifikuar, përcakton të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të fëmijëve. Vendosi që të gjithë fëmijët dhe të rinjtë të kenë të drejtën e arsimimit; kohën e lirë, lojën dhe kulturën; informacionin e duhur; liria e mendimit dhe e shprehjes; dhe privatësinë, dhe për të shprehur pikëpamjet e tyre mbi çështjet që i prekin ata në përputhje me kapacitetet e tyre në zhvillim. Konventa mbron gjithashtu fëmijët dhe të rinjtë nga të gjitha format e dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe diskriminimit të çdo lloji, dhe përcakton se interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata kryesore në çdo çështje që i prek ata.

Prindërit, kujdestarët, arsimtarët dhe anëtarët e komunitetit, përfshirë drejtuesit e komunitetit dhe aktorët e shoqërisë civile, kanë përgjegjësinë të ushqejnë dhe mbështesin fëmijët dhe të rinjtë gjatë kalimit të tyre në moshën e rritur. Ndërsa teknologjitë në internet paraqesin shumë mundësi që fëmijët dhe të rinjtë të komunikojnë, të mësojnë aftësi të reja, të jenë krijues dhe të kontribuojnë në përmirësimin e shoqërisë për të gjithë, ato

gjithashtu mund të paraqesin rreziqe të reja për sigurinë e fëmijëve dhe të rinjve. Ata mund t'i ekspozojnë fëmijët dhe të rinjtë ndaj rreziqeve dhe dëmeve të mundshme që lidhen me çështjet e privatësisë, përbajtjes së paligjshme, ngacmimit, ngacmimit në internet, keqpërdorimit të të dhënave personale ose pastrimit për qëllime seksuale dhe madje abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve. Ata gjithashtu përballen me rreziqe që lidhen me privatësinë në internet kur përdorin internetin. Fëmijët, për nga natyra e moshës së tyre dhe zhvillimi i pjekurisë, shpesh nuk janë në gjendje të kuptojnë plotësisht rreziqet që lidhen me botën në internet dhe pasojat e mundshme negative të sjelljes së tyre të papërshtatshme mbi të tjerët dhe veten e tyre.

Shumë pak gjëra në jetë mund të konsiderohen absolutisht të sigurta dhe pa rreziqe gjatë gjithë kohës. Edhe në qytete ku lëvizja e trafikut është shumë e rregulluar dhe e kontrolluar nga afër, aksidentet ende ndodhin. Me të njëjtën argument, hapësira kibernetike nuk është pa rreziqe, veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë. Fëmijët dhe të rinjtë mund të mendohen si marrës, pjesëmarrës dhe aktorë në mjedisin e tyre në internet.

Rreziqet me të cilat përballen mund të kategorizohen në katër fusha:

1- Përbajtje e papërshtatshme - Fëmijët dhe të rinjtë mund të pengohen në përbajtje të papërshtatshme dhe të paligjshme ndërsa kërkojnë diçka tjetër duke klikuar në një lidhje të padëmshme në një mesazh të çastit, në një blog ose kur ndajnë skedarë. Ata gjithashtu mund të kërkojnë dhe ndajnë materiale të papërshtatshme ose të ndjeshme ndaj moshës. Ajo që konsiderohet përbajtje e dëmshme ndryshon nga vendi në vend; shembujt përfshijnë përbajtje që promovon abuzimin e substancave, urrejtjen racore, sjelljen e rrezikut, vetëvrasjen, anoreksinë ose dhunën.

2- Sjellje e papërshtatshme - Fëmijët dhe të rriturit mund të përdorin internetin për të ngacmuar apo edhe shfrytëzuar njerëz të tjerë. Fëmijët ndonjëherë mund të transmetojnë komente lënduese ose imazhe të turpshme ose mund të vjedhin përbajtje ose të shkelin të drejtat e autorit.

3- Kontakt i papërshtatshëm - Të rriturit dhe të rinjtë mund të përdorin internetin për të kërkuar fëmijë ose të rinj të tjerë që janë të prekshëm. Shpesh, qëllimi i tyre është të bindin objektivin se ata kanë zhvilluar një marrëdhënie kuptimplote, por qëllimi themelor është manipulues. Ata mund të kërkojnë ta bindin fëmijën të kryejë veprime seksuale ose veprime të tjera abuzive në internet, duke përdorur një kamerë në internet ose pajisje tjetër regjistruese, ose do të përpiqen të organizojnë një takim personal dhe një kontakt fizik. Ky proces shpesh referohet si "rregullim".

4- Rreziqet tregtare - Kjo kategori i referohet rreziqeve të privatësisë së të dhënave në lidhje me mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të fëmijëve, si dhe marketingun dixhital. Siguria në internet është një sfidë e komunitetit dhe një mundësi për industrinë, qeveritë dhe shoqërinë civile për të punuar së bashku për të vendosur parimet dhe praktikatat e sigurisë. Industria mund të ofrojë një varg qasjesh teknike, mjetesh dhe shërbimesh për prindërit, dhe fëmijët dhe të rinjtë, dhe duhet së pari dhe më kryesorja të krijojë produkte që janë të lehta për t'u përdorur, të sigurt nga modeli dhe të përshtatshme për moshën për gamën e gjerë të përdoruesve. Siguria e fëmijëve dhe përdorimi i përgjegjshëm i teknologjisë duhet të konsiderohet me kujdes.

Forma e keqtrajtimit ndaj fëmijëve dhe elementet e identifikimit të dhunës ndaj tyre:

ABUZIMI FIZIK

Është ushtrimi i forcës me anë të së cilës dëmtohen indet e buta, lëkura, sytë, veshët, organet e brendshme, ligamentet, kockat, djegja dhe helmimi.

Fëmija i cili është viktimë e abuzimit fizik mund të prezantojë shenjat e dëmtimit të përsëritshëm në intervale kohore të rregullta. (P.sh. Në fundjavë kur prindërit nuk ndodhen në shtëpi dhe fëmija qëndron me kujdestarin.) (Më poshtë janë të listuara shenjat fizike të cilat sugjerojnë praninë e dëmtimeve jo aksidentale tek fëmijët).

- Frenulum i shqyer nga ushqyerja me biberon.
- Sy të nxira në moshën kur fëmija sapo fillon të ngrihet në këmbë.
- Shenja gishtash në faqe (zakonisht nga njëra anë).
- Shenja të kuqe ose mavi si rezultat i hemoragjisë nën lëkurë. (Është e rëndësishme të japim një vlerësim për moshën e shenjave pa pretenduar të jemi egzak.
- Guida është e vlefshme për dëmtime superficiale, sepse dëmtimet e thella dhe në zonat vaskulare zhvillohen ndryshe.
- 24/ orë e kuqe e purpurt, 2-48/orë mavi, 48-72/ orë kafe, mbi 72/ orë e verdhë)
- Hemoragji retinale (Sindrom i bebes së shkundur.)

- Dëmtime të jashtëme perivaginale, perianale.
- Kafshime.
- Mungesë flokësh si rezultat i shkuljes së tyre, presencë hematome.
- Djegje me flucka, e thatë, nga flaka, me cigare, elektrike, me fërkim, kimike, me rrezatim.

Pavarësisht nga shenjat e mësipërme të cilat vetëm sugjerojnë për një abuzim fizik të mundshëm realisht është e vështirë të diagnostikosh abuzimin fizik. Diagnostikimi i tij është një veprim i vështirë si intelektual dhe klinik, jo vetëm për kohën e nevojshme, eksperiencën, por dhe për energjitë emocionale. Bariera më e madhe e diagnostikimit është prezenca e dilemave emocionale tek profesionistët, të cilat mund të jenë kaq të fuqishme sa të pengojnë diagnostikimin dhe në rastet më të dukshme. Profesionistët përpiqen të mos bëjnë prezent problemin jo vetëm për shkak të vështirësive teknike, por dhe për shkak të frikës të prishjes së mardhënieve, raporteve mjek-pacient-familje.



Lista e mëposhtme përcakton 7 pika klasike për diagnozën ku asnjëra prej tyre nuk është diagnostikuese, por mungesa e njërës prej tyre nuk përjashton diagnozën

1. Gjendet vonesë në kërkimin e ndihmës mjekësore.
2. Historia e aksidentit është e dyshimtë, mungojnë detajet dhe mund të variojë tregimi nga një person tek tjetri.
3. Shkaku i aksidentit nuk përputhet me dëmtimet e vërejtura.
4. Veprimet e prindërve janë jo normale. Prindërit normalë janë të preokupuar për fëmijën, ndërsa prindërit abuzues nuk janë të preokupuar për kthimin sa më të shpejtë të fëmijëve në shtëpi.
5. Sjellja e prindërve është e çuditshme, ata janë armiqësorë në bisedë dhe atakohen për gjënë më të vogël, edhe kur nuk kanë arsye.
6. Pamja e jashtme dhe lidhja e fëmijës me prindërit e tij është anormale. Fëmija është i mërzhitur, i tërhequr, i friksuar.
7. Fëmija mund të kallzojë apo rrëfejë, por kjo intervistë duhet bërë në një vend privat të sigurt. Spitali është një mundësi e mirë për këtë problem.

ABUZIMI SEKSUAL

Sipas një marveshjeje ndërkombetare dhe specifike abuzimi seksual ndodh: Kur një adult shfrytëzon autoritetin e tij ose të saj për të detyruar një fëmijë të marrë pjesë në një aktivitet seksual.

Një fëmijë nuk është asnjëherë në gjendje të bëjë një zgjidhje të përshtatshme rreth aktit seksual. Abuzimi seksual mund të kufizohet që nga përkëdheljet dhe llastimet e deri te kontaktet seksuale apo bashkëveprimet vaginale, orale ose anale. Abuzimi seksual përfshin prekjet e fëmijës në vendet intime, por dhe detyrime të fëmijës për të prekur të rriturit në pjesët intime të trupit, përdorja e fëmijës për filma dhe fotografi pornografike, shfrytëzim prostitucioni etj.



Më poshtë po listojmë disa elementë të cilët ngrenë dyshimin për abuzim seksual ku mungesa e çdo njërit prej tyre nuk e përjashton diagnozën.

1. Dëmtime në zonën genitalo-anale
2. Histori me ankesa somatike si dhimbje frekvente, irritime genitale enurezis, enkomprezis, dhimbje abdominale, infeksione urinare etj.
3. Sëmundje seksualisht te transmetueshme si sifilizi, gonorea, sëmundje ku shkaktari është klamidja, virusi I papilonus humane HPV, vaginoza bakteriale (BV), virusi i imunodeficeses humane HIV.
4. Gravidancë nën moshën 16 vjeç
5. Fëmijë me sjellje seksuale te papërshtatshme-vojozizem (kur observohet fëmija në pjesët intime gjatë aktit të urinimit nga i rrituri), përkëdhelje në pjesët intime, prostituim, pornografi, bashkëveprime vaginale, anale, orale).
6. Neuroza obsesive, frikë për t'u kthyer në shtëpi, fëmijë I mbyllur në vetvete, me vetëvlerësim të ulur, zakone te çuditshme si ngrënie thonjsh, etj.
7. Fëmijë me njohuri seksuale jo të përshtatshme për moshën.

Element i rëndësishëm për vënien e diagnozës është intervista klinike e detajuar, mbajtja e shënimeve me interes të veçantë. Për traktin genito-urinar, fëmija duhet të ekzaminohet vetëm pasi të jetë bërë një marrëveshje me prindërit për moshat fëmijërore dhe për adoleshentët me vetë personin. Kusht i domosdoshëm është që ekzaminimi të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur pas marrëveshjes në një ambient komfort dhe të sigurt. Fotografitë e zonës genito-anale kanë avantazh, por ato duhen bërë vetëm në ato raste kur nuk i krijojnë stres fëmijës.

Ekzaminimi i aparatit gjenital do të evidentojë:

-Dëmtime traumatike dhe infektive te cilat duhet të trajtohen.

-Do të vlerësojë natyrën e abuzimit.

-Do të merren masa për të mbrojtur fëmijët në të ardhmen.

-Do të mbështetësh fëmijën emocionalisht (fëmija ndihet i vetem dhe është konshient që dëmtime serioze kanë ndodhur tek ai).

-Do të fillojë procesi i zbulimit të abuzuesit.

Pjesë e rëndësishme e egzaminimit është observimi i hymenit, orificiumit të tij. Orificiumi normal është 0.5-0.6cm., ai i abuzuar është 1.5 cm.

Hymeni mund të jetë i dëmtuar nga:

- Abuzimi seksual.
- Sëmundjet genitale.
- Vetëdëmtimet.
- Dëmtimet aksidentale.

ABUZIMI EMOCIONAL

Ky term ka të bëjë me braktisjen emocionale të mjaftueshme për të shkaktuar dëmtim në zhvillimin fizik ose patologjik të fëmijës, term i cili përdoret edhe për abuzimin verbal të mjaftueshëm për të dëmtuar zhvillimin. Abuzimi emocional shpesh herë shoqëron format e tjera të abuzimit të fëmijës. Në këto raste fëmija mund të ketë nevojë për këshillim, ose në raste të tjera më të rënda për ndarje nga prindërit.

Ç' ndodh me një fëmijë të abuzuar emocionalisht?

Ai:

- fyhet
- nuk stimulohet
- lihet në harresë
- i flitet me ton të ashpër
- nuk dëgjohej me vëmendje
- ndërpritet iniciativa
- tallet
- përdoret ironia
- abuzohet fizikisht, seksualisht, apo incest.
- dekurajohet
- i shkaktohet dhimbje emocionale, distres, frikë dhe gjendje dëshpërimi.

Çfarë formash përdorin abuzuesit?

- Braktisjen
- Izolimin
- Terorizimin ose friksimin
- Injorimin
- Korruptimin

Abuzimi emocional identifikohet nga observimet dhe raportet e sjelljes së kujdestarit.

Sjellja e kujdestarit

Kur ka mundësi një profesionist duhet të observojë kujdestarin e dyshuar për abuzimin emocional dhe ndërveprimin me fëmijën. Për të marrë një shembull të dukshëm rreth marëdhënies kujdestar-fëmijë dhe për të kapur

modelet e sjelljes kronike duhen bërë observime në disa raste. Psikologjikisht prindërit që abuzojnë janë kritikë, përçmues, dhe kërcënojnë se do ta braktisin fëmijën e tyre (psh., “bëje dhe një herë se do të përze”), i bëjnë fëmijës së tyre kërkesa të papërshtatshme me moshën (psh., duke i thënë fëmijës së tyre të shkojë në guzhinë dhe të marrë cigaret dhe shkrepsat, kur ai është vetëm 2 vjeç, për mikun), injorojnë qarjet, frikën apo mërzitjen e fëmijës.

Observimet e thjeshta kanë kufizime për arsye se shumë prindër mund të mos sillen në mënyrën e tyre tipike.

Observimet e raportuara nga një kujdestar tjetër, nga kushërinjtë apo të njohurit, në shumicën e rasteve sjellin dyshime që duhet të merren në konsideratë. Këto raporte origjinale duhet të eksploroohen plotësisht dhe me kujdes. Për këtë mund të fitohet informacion nga intervistat me kujdestarin dhe fëmijën, të shihen regjistrat, raportet kolaterale nga bebisiterat, fqinjët, kushërinjtë, personeli shkollor.

Profesionisti duhet të njohë gjendjen e kërkesave të statutit të shtetit të tij, për të raportuar abuzimin emocional. Disa shtete kërkojnë të dhëna të dëmtimit mendor duke përfshirë format ritmike të observimit, rishikimin e shpejtë të kontakteve të profesionistëve të tjerë me fëmijën dhe familjen (psh., ato të personelit shkollor të kujdesit të përditshëm dhe shëndetsor), dhe vlerësimin psikologjik.

Sjellja e fëmijës

Sjellja e fëmijës mund të tregojë që ka ndodhur abuzim emocional. Fëmijët e abuzuar emocionalisht mund të jenë të frikësuar apo të shqetësuar, të zemëruar me kujdestarin e tyre apo në përgjithësi e injorjnë atë, ndërsa fëmijët e rritur siç duhet janë të rehatshëm dhe konfidetë nga prezenca e kujdestarit të tyre. Sidoqoftë, vetëm sjellja e fëmijës nuk është e mjaftueshme për të nxjerrë thelbin e një rasti. Dëmtimet mendore tek fëmijët mund të shkaktohen nga shumë faktorë, si sëmundje mendore, vonesë mendore, autizëm si edhe trauma psikologjike që nuk lidhen me sjelljen e kujdestarit. Sidoqoftë fëmijët me këto probleme mund të jenë edhe të abuzuar emocionalisht. Përjashtimi i problemeve të tjera për sjelljen problematike mund të bëhet nga studiues të rastit me eksperiencë në fëmijët me sëmundje mendore, vonesa të zhvillimit dhe trauma.

Niveli i Gravitetit

Për të plotësuar nivelin e gravitetit të abuzimit emocional, duhet të përdoren udhëzuesit e mëposhtëm:

- sa intense, ekstreme dhe kronike është sjellja?
- në çfarë shtrirje është marëdhënia fëmijë-kujdestar që lejohet nga abuzimi?
- sa forma të keqtrajtimit psikologjik kanë ndodhur?
- a ka njerëz të tjerë në jetën e fëmijës që tamponojnë abuzimin emocional? (psh një raport i ngushtë me të atin mund ta mbrojë fëmijën nga një nënë verbalisht abuzive).
- kush është rëndësia e sjelljes të përshtatshme të kujdestarit në lidhje me nevojat e zhvillimit të fëmijës? (Psh një kujdestar që ndërvepron me fëmijën vetëm duke e ushqyer dhe duke ndëruar pelenat, injoron nevojat e ndërveprimit me anë të ngrohtësisë dhe e vendos fëmijën në një risk të dukshëm të zhvillimit.)
- deri në çfarë mase ka të dhëna që fëmija është dëmtuar nga kujdestari? Psh një mungesë e interesit për botën mund të jetë e dhënë e mundëshme e dëmtimit për arsye se sjellja e deprimuar, pasive shpesh shihet në fëmijët e neglizhuar emocionalisht dhe rrallë në fëmijët e tjerë. Vazhdimi i këtij modeli sjelljeje do të pengojë zhvillimin emocional dhe konjitiv.



NEGLIZHIMI

Neglizhimi përfshin lënien pas dore të nevojave fizike dhe emocionale, arsimimin, sigurinë dhe kujdesin mjekësor, të cilat mund të shkaktojnë dëmtim fizik ose psikologjik.

- Mungesë e afinitetit apo afinitet i keq. Disa fëmijë – që nuk kanë tjetër njeri kanë afinitet të lartë me prindër të rrezikshëm apo abuzivë.
- Pamundësi për të ushqyer fëmijën në mënyrë të mjaftueshme pavarësisht se ushqimi është i mjaftueshëm.
- Mungesë flagrante apo kronike në supervizionin e fëmijës.
- Mungesë e përcaktimit të duhur apo të përhershëm të kufijve.
- Mungesë e nxitjes së zhvillimit.
- Mungesë e udhëzuesve dhe kujdesit emocional për mirërritjen emocionale të fëmijëve..
- Pamundësia për të siguruar që fëmija të marrë kujdesin mjekësor të duhur, veçanërisht kur ky kujdes është i arritshëm, falas apo i përballueshëm. Kjo mund të ndodhë për mungesë të gjyqimit dhe motivimit.
- Pamundësia për të dërguar fëmijët rregullisht në shkollë.



Fëmija ka të drejtë të ketë, dhe prindi ka për detyrë t'i japë atij në mënyrë të arsyeshme dhe të kujdesshëm ushqim, veshje, strehë, supervizion, kujdes mjekësor, edukim dhe arsim.

PASOJAT AFATSHKURTRA DHE AFATGJATA TË ABUZIMIT TË FËMIJËVE

• Pasoja Mjekësore

a- Afatshkurtra

- infeksione të rrugëve gjenitale.
- hemoragji të organëve të brendshme.
- dëmtime të organeve.
- frakturane sistemin kockor.
- sëmundje seksualisht të trasmetueshme (SST).
- temperaturë.
- gjendje septike.
- plagë në lëkurë.
- hematome akute kraniale.
- hematoma në lëkurë.

b- Afatgjata

- shtatzani,
- sëmundje kronike,
- SST,
- HIV,
- dhimbje koke

v Pasoja psikologjike

a-Afatshkurtra

- konfuzion,
- humbje të konshiences,
- mungesë oreksi,

- amnezi (humbje te kujteses),
- afazi (paaftesi per te folur)
- agnozi te perkohshme (paaftesi per te njohur).

b-Afatgjata

- crregullim i stresit post traumatik (PTSD)
- shpërthime nervore.
- kujtime intensive ose ëndërra të këqija të lidhura me abuzimin.
- vërshime ndjenjash sikur abuzuesi është prezent përsëri.
- çrregullime të gjumit.
- vështirësi në përqëndrim.
- shmangia nga aktivitetet ose veprimet që mund të kujtojnë abuzimi
- **Pasoja sociale**
 - stigmatizim,
 - gjendje te keqe ekonomike,
 - papunesi.
- **Pasoja Ligjore**
 - procedure ligjore per te denuar dhunuesin

ELEMENTË TË KOMUNIKIMIT ME FËMIJËT E DHUNUAR

o Dëgjimi aktiv

Ndihmoheni fëmijën që të ndihet: i pranuar, jo i vetmuar, më i fortë

o Largoni burimet e ndërprerjeve

Aktivitetet e tjera

Zhurmën dhe lëvizjet e jashtme

Mendimet tuaja të paparashikuara

Stresin tuaj personal

o Përgjigjuni ndjenjave, jo informacioneve

o Nxiteni fëmijën të flasë

o Dëgjoni; mos flisni shumë

o Përdorni nxitjet

“Më trego më shumë.” “Vazhdo.”

o Tregohuni empatik

“Ajo duhet të ketë qenë shqetësuese për ty.”

o Parafrazo apo rithekso

o Përdorni vetëtërheqjen

o Por jo në atë masë sa të largoheni nga tjetri

o Qartësoni

“Më duket se ju thoni...” “A mendoni për...?”

o Vlerësoni

Kompliment: “Ju jeni një person që...”

o Shmanguni fjalëve dhe veprimeve dekurajuese dhe këshillave të vazhdueshme

Zakonisht fëmija do që ju vetëm ta dëgjoni.

Shmanguni dhënies së këshillave përderisa fëmija nuk i kërkon ato.

o Shmangni vetëreferimin

Mos i impononi vlerat tuaja; mos i thoni fëmijës:

“Në këtë situatë unë do të vepra në këtë mënyrë.”

o Shmangni refuzimin joverbal

Hutesa dhe largimi i kontaktit me sy.

o Shmangni sulmet apo nënçmimet

o Shmangni mohimin e ndjenjave

“Ti në të vërtetë nuk ndihesh nervoz.”

o Mos manifestoni humor të papërshtatshëm

o Pranimi i ndjenjave

Në mënyrë që t'i ndihmojnë fëmijët për t'u ballafaquar me ndjenjat e tyre, prindërit duhet t'i pranojnë dhe t'i respektojnë ndjenjat e fëmijëve.

- **Dëgjoni të qetë, me kujdes dhe me vëmendje të plotë**

- **Pranoni ndjenjat me një fjalë**

Në vend të pyetjeve (“Pse e bëre atë?”)

dhe këshillave (“Pse nuk...?”)

Përgjigjuni me fjalë, si: “Aha... Po... Po e vërej...”

- **Emërtoni ndjenjat**

Në vend të mohimit të ndjenjave (“Ajo nuk ishte edhe aq neveritëse”), emërtoni ndjenjën.

“Kjo duket shumë neveritëse!” “Kjo duhet të jetë shumë e keqe.”

“Me siguri ju ka marrë malli për atë.”

Kur ne përpiqemi që fëmija ta largojë një ndjenjë negative nga vetvetja, fëmija vetëm se do të neveritet më shumë. Fëmija, ndjenjat e të cilit janë të përshkruara me fjalë të veçanta, ndihet i qetësuar dhe i ngushlluar. Dikush po e përjeton përvojën e tij të brendshme.

- **Thoini fëmijës dëshira të imagjinuara**
Në vend të shpjegimeve dhe logjikës, thoni:
“Sa do të dëshiroja të ishte një bar magjik që do të të ndihmonte në zgjidhjen e këtyre problemeve matematike.”

Tregoni se të gjitha ndjenjat duhet të pranohen. Veprime të caktuara duhet të ndalohen
“Unë e shoh se sa je nervoz. Atë që dëshiron, shokut tënd thuaja me fjalë, jo me grushte.”

- o **Dëgjoni me kujdes**

Kontakt me sy dhe të folurit e trupit. Shprehje të empatisë si “aha, mmm, po kuptoj...”

- o **Nxiteni bisedën e mëtejme – hapja e**

derës

Vëre veten në pozitë të tij.

“Kjo duhet të jetë e tmerrshme për ty.”

- o **Provoni ndjenjat**

“Tingëllon sikur vërtet je hidhëruar, pikëlluar shqetësuar për këtë.”

- o **Bëhuni kureshtar**

Pyetje të hapura, pa tingëlluar paragjykuese. (mos u përgjigjini me Po – Jo)

- o **Ritregoni faktet dhe ndjenjat**

Përsëritni disa fjalë të fundit.

Ritregoni me mirëkuptim (jo si papagall).

ZVILLIMI I EMPATISË TEK FËMIJËT

Fëmijët që janë të qëndrueshëm dhe që kanë besim tek vetvetja zakonisht kanë më pak vështirësi në jetë. Trajtimi i fëmijëve me respekt dhe me dinjitet është një shembull se si do të dëshironim që të na trajtonin fëmijët tanë ne dhe të tjerët. Ndihma që ne u japim fëmijëve për të kuptuar ndjenjat e të tjerëve dhe për të pasur konsideratë për veten e tyre, ndërton rrugën e cila i bën ata më të pjekur dhe më të kujdesshëm.

EMPATI

Është aftësia e një personi që të përceptojë emocionet, nevojat dhe dëshirat e një personi tjetër. Është aftësi e një personi që të ecë me këpucët e personit tjetër dhe të shohë se si është të ecësh me ato këpucë.

Ja disa mënyra si mund t'i ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e ndjenjës së empatisë:

- **Disiplina**
Përdorimi i mënyrave disiplinore emptaikë, të kujdesshme dhe pa dhunë, është një hap i drejtë në këtë rrafsh. Goditja, kritika dhe nënçmimi janë bllokada të zhvillimit të empatisë.
- **Shfaqja e ndjenjave**
 - Fëmijët kanë të drejtë të shfaqin atë që duan. Ajo që atyre u nevojitet të dijnë janë mënyrat e pranueshme të shfaqjes së ndjenjave. Adltët të cilët i frenojnë fëmijët në shprehjen e emocioneve, që I thonë: mos qaj, mos u bëj nervoz ose mos u frikëso, dështojnë në zhvillimin e empatisë dhe në të

njetën kohë ua mësojnë fëmijëve shmangien nga shpjegimi e ndoshta edhe nga përjetimi i emocioneve të caktuara

- Identifikoni dhe vlerësoni ndjenjat e fëmijës
Fëmijët kanë të drejtë mbi ndjenjat e tyre. Njohja e emocioneve ndihmon fëmijët që të bëhen më të vetëdijshëm dhe që në mënyrë sa më konstruktive të ballafaqohen me to.
- Demonstroni empatinë
Kur adultët demonstrojnë empatinë, ata mësojnë fëmijën si të reagojë kur dikush tjetër është i mërzitur dhe i shqetësuar.
- Zhvilloni ndjenjën familjare të moralit
Mësoni fëmijët se cilat sjellje moralisht janë të drejta dhe cilat të gabuara.
- Rregullat në familje
“Jo goditjes, jo prekjeve dhe fjalëve që lëndojnë” – duhet të jetë në çdo listë të rregullave shoqërore.
- Ndikimi i sjelljeve
Ndihmoni fëmijët të kuptojnë shkakun dhe efektet e nocionit të empatisë. Kur fëmijët sillen në një mënyrë, sjellja e tyre ka një përgjigje për dikë tjetër. Qëllimi është që fëmijët të mendojnë se sjellja e tyre mund të nxisë reagim tek të tjerët.
- Vështroni të tjerët
Kërkoini fëmijës të komentojë situatë të ndrushme, portrete të ndryshme, biseda njerëzish.
- Mësojeni fëmijën që të kujdeset për bimët, për këlyshët dhe për gjësendet
Ushqimi i këlyshve, ujitja e luleve, trajtimi i lodrave dhe i objekteve të tjera me respekt janë mënyra të shkëlqyeshme të mësimin të empatisë.
- Kundërpërgjigjet joverbale
Mësojeni fëmijën që t`u kushtojë kujdes parashenjave joverbale të të tjerëve. Fëmijët duhet të dijnë për parashenjat që ia bëjnë me dije atij që të ndalet para se ta ndal dikush.
- Mësojeni fëmijën të ndajë
Përderisa fëmijët zhvillojnë ndjenjën e besimit në botë, ata kuptojnë se kur diçka jepet, nuk jepet përgjithmonë, por përkohësisht. Pas një kohe të shkurtër, ata do ta marrin prapë atë. Ja disa gjëra që duhet të mbahen në mend rreth ndarjes:

MESIMI DHE ORIENTIMI I FEMIJEVE ME DISIPLINE

Qëllimi i masave disiplinore është mësimi dhe orientimi, e jo ndëshkimi si qëllim i vetvetes. Qëllim yni është që fëmijët t`i mësojmë të bëhen të disiplinuar, në mënyrë që ata të mësojnë nga gabimet e veta, të zhvillojnë vlerat dhe vetëdijen morale.

Motivet e sjelljeve të këqija

Sipas modelit të Alfred Adlerit dhe Rudolf Dreikursit (Fëmijët: sfidë), është merëndësi përcaktimi i motiveve të fëmijëve për sjellje të këqija dhe reagimi në mënyrën e caktuar. Prindërit dhe mësuesit mund të zbulojnë qëllimin e fëmijës sipas asaj se si të **ndihen të rriturit**.

Nëse fëmija kërkon **KUJDES TË TEPRUAR**, të rriturit ndihen të shqetësuar.

Nëse fëmija tregon **REZISTENCË TË FORTË**, të rriturit ndihen të zemëruar ose të sfiduar.

Nëse motivi i fëmijës është **HAKMARRJA**, të rriturit ndihen të lënduar

Dhe nëse fëmija sillet **ME ZEMËRNGUSHTËSI DHE PAAFTËSI TË PARAMENDUAR**, të rriturit ndihen të frustruar dhe të dekurajuar.

Çfarë mund të bëjnë në raste të tilla prindërit dhe mësuesit?

Motivi: Kujdesi

Mos i kushtoni kujdes fëmijës vetëm pse e gjakon atë duke u përpjekur që vetëdijshtëm atë ta arrijë me sjellje të keqe. Çjerrjet, kundërshtimi dhe sharjet i mësojnë fëmijët se mund ta tërheqin vëmendjen (qoftë kjo edhe negative) me sjellje të keqe. Në vend të kësaj, përpiquni të injoroni sjelljen që nuk lejohet, porse njëherësh përpiquni t'i kushtoni kujdes dhe me fjalë t'ia thoni sjelljen që është e lejueshme. Me fjalë të tjera, vërejeni fëmijën kur sillet mirë! Gjeneroni kohë vetëm për të dhe kaloni së bashku – bindeni se nuk ka nevojë të sillet keq për t'i kushtuar ju kujdes.

Motivi: Rezistenca

Bëni diçka. Ndërmerrni iniciativë, porse jo në mënyrën që do ta përçmonte fëmijën. Mos pranoni t'ju fusë në diskutim ose në grindje. Në vend të kësaj, shërbehuni me "porosinë me "UNË", ofroni mundësi për zgjedhje, caktoni pasojat logjike dhe përdorni teknikat e zgjidhjes së problemeve që do t'ju shpiejnë tek zgjidhja e pranueshme edhe për ju, edhe për fëmijën. Ndhmoni fëmijës ta ndiejë që edhe ai ka fuqi që mund ta përdorë në mënyrë konstruktive.

Motivi: Hakmarrja

Ju nevojitet shumë durim për t'iu shmangur grindjes dhe për të mos përdorur ndëshkime të ashpra ndaj fëmijës që shfrytëzon këtë motiv. Me rëndësi është të hetohet fëmija që do t'i fyejë të tjerët ngase ka qenë i fyer. Për këtë arsye dëgjoni dhe të fëmija zhvillojeni vetërespektin dhe imazhin pozitiv për vetë atë dhe ndihmoni që t'i shfaqë ndjenjat e tij në mënyrë më pak të dëmshme.

Motivi: Dekurajimi

Ky fëmijë shpejt do të thotë: “Nuk mundem.” Prindërve dhe dhe mësuesve nuk do t’ju duhej të lejonin të merrnin detyrimet e fëmijës dhe t’i kryenin të gjitha në vend të tij. Në vend të kësaj, nxiteni mëvetësinë dhe iniciativën. Lejoni t’ju ndihmojë juve dhe t’u ndihmojë fëmijëve më të vegjël. Mësojeni se në rregull është edhe të gabohet, se mësohet edhe nga gabimet. Kërkoni anët dhe aftësitë më të mëdha që fëmija juaj i ka dhe bëni hapa të vegjël drejt suksesit.

Strategjitë pozitive disiplinore

Strategjitë e mëposhtme kanë natyrë parandaluese dhe janë të formuluar në atë mënyrë që të parandalojnë të mos kalojë situata deri në atë pikë në të cilën prindi do të ndihej i nervozuar dhe i frustruar. Asnjë nga strategjitë disiplinore nuk janë efektive për të gjithë fëmijët dhe në të gjitha situatat dhe shumica prej tyre kanë nevojë të përpunohen në mënyrë që të kenë efekt dhe të jenë të përshtatshme.

• Përgatiteni fëmijën

Tregoni fëmijës se çfarë po ndodh. Shprehni qartazi pritjet tuaja rreth sjelljeve të fëmijës dhe krijoni një ambient që u përshtatet këtyre pritjeve.

“Ne do të ndalemi te banka. Ti nuk mund të vraposh rreth e qark, por ka karrige të veçanta, ku ti do të mund të ulesh dhe të lexosh ndonjë tregim. Cilin tregim dëshiron ta lexosh?”

• Njihuni me ndjenjat e fëmijës

Tregoni fëmijës se çka mendoni që ndien ai. Kur fëmijët ndiejnë se po i kuptojnë, janë më të prirur për përgjigje pozitive. Bëhuni empatik dhe përqëndrohuni në sjelljen, jo në fëmijën. *“Shibet se ti dëshiron të luash me nënën njëherë. Nganjëherë është vështirë të presësh.”*



- **Përcaktoni kufij për sjelljet e padiskutueshme**

Thuajani fëmijës qartazi kufijtë dhe ndiqni ata me vendosmëri.

- **Ofroni zgjidhje, në vend se të jepni urdhëra**

Askush në botë nuk i ka në qef urdhërat. Kur fëmija zgjedh alternativën, ai është më i angazhuar rreth rezultatit. Ofro një zgjidhje ndërmjet dy alternativave të pranueshme.

- **Zgjidhni problemet bashkërisht**

Gjeni kohë për t'u ulur me fëmijën dhe për t'i përshkruar gjendjen. Pranoni ndjenjat e fëmijës dhe shkëmbeni ato me tuajat pa gjykuar. Mendoni bashkërisht rreth zgjidhjeve të mundshme dhe provoni të tjera në qoftë se njëra nuk hyn në punë.

- **Siguroni forcë pozitive**

Kur fëmija sillet mirë, lavdërojeni dhe nxiteni atë. Bëhuni i veçantë. Pranoni çdo shenjë të progresit drejt sjelljes së dëshiruar, pa marrë parasysh se sa e vogël është. Përqëndrohuni më shumë në përpjekjen, jo në rezultat.

- **Shpërqëndrojeni vëmendjen e fëmijës**

Shpërqëndrojani vëmendjen fëmijës nga konflikti, në një aktivitet të ri. Në qoftë se kjo nuk është e mundur, atëherë përdorimi i humorit, i imagjinatës ose i lojës në një gjendje e cila del jashtë kontrollit shpesh e neutralizon atë.

- **Lejoni fëmijët që t'i përjetojnë pasojat e veprimeve të tyre**

Ne gjithmonë nuk u bëjmë mirë fëmijëve duke i shpëtuar ata nga situatat e vështira. Për shembull, në vend se të zemërohemi se duhet t'ia dërgoni drekën fëmijës suaj në shkollë për herë të dytë në këtë javë për shkak se ai e ka harruar, ju mos ia dërgoni. Ai do të marrë një mësim shumë të vlefshëm rreth përgjegjësisë, pa pasur nevojë që ju ta qortoni

Ç'është kontrollimi i sjelljes?

Kontrollimi i sjelljes është një term që përdoret për të shpjeguar teknikat që të rriturit i përdorin për t'i ndihmuar fëmijët në mësimin e sjelljeve të hijshme dhe të dëshirueshme. Shembuj të kontrollimit të sjelljes përfshijnë lavdërimin për sjelljen e dëshiruar, injorimin e sjelljes së pahijshme, demonstrimin e sjelljeve të hijshme dhe dënimin për sjelljet e padëshiruara. Këto teknika përdoren nga të rriturit që t'i mësojnë fëmijët e tyre për t'i respektuar rregullat, për t'i përmbushur pritjet e prindërve në aspektin e sigurisë, aktivitetit në shkollë dhe pastërtisë, si dhe për të ndëshkuar sjelljet e papranueshme. Vetëdijshëm ose pavetëdijshëm, ju si të rritur në vazhdimësi përdorni teknikat e kontrollimit të sjelljes.

Ç'është disiplina?

Disiplinë janë rregullat, udhëzimet dhe standardet e sjelljeve të pranueshme që të rriturit i përcaktojnë për fëmijët. Disiplinën e përbëjnë kufijtë përbrenda të cilëve fëmijët mësojnë të sillen në mënyrë të pranueshme nga shoqëria. Për shembull, disiplina mund të përfshijë përgjegjësitë e fëmijës në shtëpi, koha e caktuar me saktësi për dalje, rregullat familjare, siç janë ndalimi i rrahjes ose i hedhjes së gjërave, mbajtja e pastërtisë dhe pasojat për mosrespektimin e rregullave. Porosia të cilën prindërit ua dërgojnë fëmijëve nëpërmjet disiplinës është: *“Unë kujdesem për ty dhe përcaktoj kufij e pasoja që do të të ndihmojnë ty të kontrollosh sjelljet e tua.”*

Ç'është ndëshkimi?

Ndëshkimi është një dënim që ushtrohet mbi fëmijën nga të rriturit, kur fëmija ka zgjedhur thyerjen e një apo më shumë rregullave, udhëzimeve, ose standardeve të sjelljeve të pranueshme e të përcaktuara nga ata. Lloje të përshtatshme të ndëshkimeve përfshijnë pauzat në lojë (Time Out), humbja e privilegjeve, ose kompensimi i caktuar për ndonjë objekt të thyer.

Dallimi ndërmjet ndëshkimit dhe disiplinës

Disiplinë janë rregullat dhe prirjet që të rriturit kanë për sjelljet e fëmijëve të tyre

Ndëshkim janë veprimet që të rriturit ndërmarrin kur rregullat qëllimisht thyhen.

Rregullat duhet të jenë të qarta dhe të qëndrueshme

Në qoftë se lojtarët nuk i dinë rregullat e lojës ose nëse rregullat ndryshojnë për çdo javë, do të ishte e pamundur që lojtarët të dinë se çka është e lejueshme e çka jo. Pa këto njohuri, lojtarët e ndëshkuar do të nervozohen dhe do të jenë të ashpër ndaj gjyqtarit.

Po e njëjta situatë und të paraqitet edhe në shtëpi. Prindërit presin që fëmijët të kenë sjellje të hijshme. Megjithatë, që fëmijët të kenë sjellje të përkufizuara nga prindërit si të hijshme, ata duhet t'i dinë rregullat – çka është dhe çka nuk është e pranueshme.

Qëndrueshmëria e rregullave ka rëndësinë e njëjtë. Në qoftë se rregullat ndryshojnë ose zhduken, rezultati do të jetë = ndjenja të ngatërresës dhe të nervozizëm.

Rregullat duhet të jenë të drejta

Rregullat e rrepta e parandalojnë mësimin e pavarësisë, autonomisë dhe përgjegjësisë. Kur fëmijët thonë se rregullat e caktuara janë shumë të rrepta, ju duhet të diskutoni këtë çështje me ta dhe të provoni të zgjidhni dallimet në vlerësim. Kur fëmijët mendojnë se rregullat janë mjaft të rrepta dhe nuk kanë mundësi t'i diskutojnë ato, atëherë ata mendojnë se rregullat si dhe ndëshkimi nuk janë të drejta.

Kohëzgjatja e ndëshkimit

Që të jemi më efektivë, ndëshkimi duhet të bëhet menjëherë pas sjelljes së pahijshme. Nëse kjo bëhet brenda një kohe të shkurtër, fëmija do të kuptojë raportin midis sjelljes së papranueshme dhe ndëshkimit. Mirëpo, nëse kalon shumë kohë, atëherë fëmijët e vegjël mund të ngatërrohen dhe të mos kuptojnë pse po ndëshkohen.

Parimësia e ndëshkimit

Për arritjen e pakësimit të rasteve të sjelljes së pahijshme të fëmijëve, ndëshkimi duhet të bëhet çdoherë kur sjellja e papranueshme ndodh. Në qoftë se fëmijët nganjëherë ndëshkohen nganjëherë jo, atëherë ata do të ndihen konfuzë, do të mësojnë si të manipulojnë dhe në të shumtën e rasteve do të mendojnë se ndëshkimi është i padrejtë.

Ndëshkimi jofyes

Goditja, qortimi dhe kërcënimi i fëmijëve janë praktika fyese. Ato u tregojnë fëmijëve se ata nuk janë të mirë, në vend se t'u tregohet se sjellja e tyre është e papranueshme.

Llojet e ndëshkimit

• Humbja e privilegjit

E përshtatshme për moshën 2,5 vjeç dhe më të mëdhenj.

Privilegji është një e drejtë që jepen nga prindërit. Kjo mund të jetë shikimi i televizorit, loja me një lodër të veçantë etj. Në qoftë se fëmija e keqpërdor objektin ose e keqpërdor privilegjin, ai e humb atë për një kohë. Merrjani lodrën a privilegjin vetëm atëherë kur fëmija e keqpërdor (hedh, thyen etj.).

• Ndalesa për dalje

Qëndrimi në shtëpi dhe humbja e disa privilegjeve brenda shtëpisë.

• Zhgënjimi prindëror

Një deklaratë e thjeshtë mund të shprehë zhgënjimin e prindit për sjelljen e fëmijës. Qëllimi është që te fëmija të krijohet vetëdija dhe kujdesi lidhur me zhgënjimin e prindit. Për shembull: *“Biri im, dëshiroj të dish se sa jam zhgënjyer që ke zgjedhur ta godasësh vëllanë tënd. Unë jam i sigurt se berave të tjera nuk do ta bësh këtë dhe atij do t'i thuash me fjalë që të mos i prekë lodrat e tua.”*

• Time Out

I përshtatshëm për moshën 3 e më shumë vjeç.

Time Out është një izolim i përkohshëm i fëmijës nga të tjerët për shkak të sjelljes së pahijshme të tij.

NJËMBËDHJETË RREGULLA DISIPLINORE

1. Ndhimoheni fëmijën që të mësojë si të sillet duke e vënë atë në prova të drejtpërdrejta, nga të cilat do të mësojë sjelljet e dëshiruara. Lejoni atij që të vërejë se po silleni siç do të donit të sillej ai.
2. Sjelljet duhet të shoqërohen me pasoja, të cilat i mësojnë fëmijët se ç'është mirë dhe ç'është keq. Pasojat me të cilat shoqërohen sjelljet e mira quhen shpërblime. Ndërkaq pasojat me të cilat shoqërohen sjelljet e këqija quhen dënime.
3. Nëse do të kujdeseni më shumë, rezultati do të jetë më i mirë. Një prej qëllimeve kryesore të edukatës është që të ndiqni se ç'sjellje kanë fëmijët
4. Dënimet (ndalesat) përdoren për t'u ndihmuar që t'i ndryshojnë sjelljet e pahijshme, ndërsa janë efektive vetëm nëse përdoren bashkë me shpërblime për stimulimin e sjelljeve të hijshme.
5. Dënimet asnjëherë nuk duhet të jenë qëllim i keqtrajtimit, shkaktimit të lëndimeve, ose i kërcënimit për t'i lënduar fëmijët.
6. Ndalimi për të dalë do të jetë efikas atëherë kur kjo kohë shfrytëzohet në mënyrë cilësore. Në qoftë se koha e ndalimit të daljes nuk shfrytëzohet në mënyrë cilësore, fëmija do ta përjetojë emocionalisht këtë ndëshkim.
7. Ndalimi për të dalë duhet të përoret me masë dhe vetëm për qëllime mësimi për fëmijët e vegjël. Për fëmijët e fazës së pubertetit dhe tek ata në këtë fazë përdoren forma të tjera të dënimeve, që janë më të përshtatshme.
8. Dënimi duhet të jetë në harmoni me shkallën e deliktit. Po ashtu, duhet të jetë i arsyeshëm, korrekt dhe të ndërlidhet me gabimin e bërë.
9. Dënimi duhet të ketë shkas dhe të mos zgjasë shumë. Dënimet e gjata nuk e motivojnë fëmijën për të mirë.
10. Në qoftë se ndalesa keqpërdoret ose përdoret në mënyrë joadekuate, duhet kërkuar masë tjetër ndëshkimi dhe mënyrë tjetër të përdorimit. Një prej qëllimeve të disiplinës është që fëmijët të mësojnë të sillen si duhet. Në qoftë se fëmijëve nuk u jepet edhe mundësi tjetër, atëherë si do të mësojnë të sillen si duhet?
11. "Në qoftë se diç shkatërron, duhet të përgjigjesh. Në qoftë se çrregullon, duhet të rregullosh." Dëmshpërblimi është mënyra më e mirë për t'i mësuar fëmijët cilat janë pasojat e sjelljes së keqe.



Teknika në lidhje me komunikimin dhe pyetjet

- ✓ Gjatë intervistave në situata të dhunës në familje duhet të komunikohet thjesht dhe në mënyrë të kuptueshme.
- ✓ Pyetjet të jenë sa më të thjeshta me pak fjalë dhe vetëm me një pyetje në të. Duhet të eliminohen fraza të tilla si: 'a mund të më thoni nëse?'; 'a ju kujtohet?';
- ✓ Duhet të fillohet me pyetje të përgjithshme sa për të krijuar mjedisin e përshtatëm dhe qetësimin psikologjik të fëmijës dhe për të kuptuar nivelin e intelektit të fëmijës. Ndër pyetjet e përgjithshme janë:
 - Sa vjeç je,
 - Çfarë klase e shkolle ndjek,
 - A janë mësimet e vështira, a ke shokë të mirë, etj.

Kalohet gradualisht në pyetjen e duhur, specifike lidhur me ngjarjen. Pyetjet specifike lidhur me ngjarjen përfshijnë:

- Çfarë ndodhi?
- Ku ishte kur ndodhi ngjarja?
- Kur ndodhi ngjarja, në mëngjes, drekë, darkë?
- Kush ushtroi dhunë?
- Ku ishte në atë kohë?
- Ishe vetëm?
- Kush ishte me ty?
- E pe atë që ndodhi apo vetëm e dëgjove?
- Çfarë dëgjove?
- A ka ndodhur dhe herë të tjera kështu? Si u ndjeve?
- Kujt i ke thënë? Çfarë bëre ti në këtë rast?
- Çfarë bën ti kur ndodhin ngjarje të tilla në familje?

Duhet lejuar fëmijën të bëjë pyetje.

Disa këshilla praktike për të patur një komunikim korrekt me fëmijët

Marrëdhëniet me fëmijët janë një ndër përvojat që më së shumti shpërblehen dhe kënaqin. Njëkohësisht është një ndër përvojat më të vështira dhe më të komplikuar. Këto marrëdhënie shpesh shoqërohen me frustrim, pritje joreale dhe ngarkohen me frustrime e mosmarrëveshje si rezultat i komunikimit të keq.



MËNYRA PËR T'U NDËRTUAR VETËRESPEKTI TE FËMIJA

- 1) Ta dëgjoni,
- 2) T'i qaseni me seriozitet dhe
- 3) Ta doni e ta pranoni pa kushtëzime.

Ekzistojnë mardhënie shumë planëshe me fëmijët. Mardhënia prind – fëmijë, profesionist fëmijë, adult – fëmijë etj. Problem më i vështirë për adultët dhe fëmijët në ditët e sotme është se asnjëri prej tyre nuk dinë të komunikojë me sukses – me respekt, me dinjitet, apo në atë mënyrë që të dy palët të ndiejnë se po dëgjohehen dhe po kuptohen. Familje që kanë fëmijë sidomos adoleshente, shumë probleme mund t'i zgjidhim duke mësuar shkathësi të mira komunikimi.

Ne komunikojmë me qëllim që të tjerëve t'ua shprehim kërkesat, opinionet, ndjenjat dhe idetë tona. Dëshirojmë që dikush tjetër të kuptojë pikëpamjen tonë, të dëgjojë atë që ne themi dhe bashkërisht të punojmë drejt zgjidhjes së problemeve.

Në qoftë se një problem nuk mund të zgjidhet, atëherë çdo person meriton respekt për atë se çka ai ose ajo ndien. Prindërit rëndom duan që fëmijët e tyre të bëjnë atë që ata kërkojnë pa shumë kundërshtime. Fëmijët ndërkaq, rëndom, dëshirojnë që prindërit e tyre thjesht t'i dëgjojnë këta. Po e njehta gjë ndodh edhe në mardhënien fëmijë – profesionist.

Ja disa udhëzime të thjeshta për adultët:

• **Mënyra për t'u ndërtuar vetërespekti** te fëmija, si dhe për të patur një mardhënie të sëndoshë është:

- 1) **Ta dëgjoni,**
- 2) **T'i qaseni me seriozitet dhe**
- 3) **Ta doni e ta pranoni pa kushtëzime.**

• **Kur e lavdëroni fëmijën**, lavdëratën tuaj orientojeni nga përpjekja, jo nga arritja. Ne shpesh i kushtojmë tepër rëndësi rezultatit përfundimtar duke mos e theksuar se sa e vështirë ka qenë të arrihet ai.

• **Mos gjykoni fëmijën**, Respektoni pikëpamjet dhe dallimet e tyre dhe lejoni t'i shprehin idetë e ndjenjat e tyre. Respektoni individualitetin, pavarësinë dhe jetën private të tyre.

• **Mos u ktheni në të kaluarën** dhe mos lejoni që ajo të ketë ndikim në të tashmen. Duke përdorur shprehjet, si “gjithmon”, “kurrë”. Ose “ndonjëherë” thjesht i kundërvihen fëmijës. Duke thënë “*Ti gjithmonë vonobesh*” ose “*Ti kurrë nuk e kryen detyrën tënde*”, vetëm ndihmoni për t'u forcuar sjelljet negative të cilat përpiqeni t'i ndryshoni. Kjo quhet profeci që e jetësoni vetë. Në qoftë se fëmijët këto i dëgjojnë mjaft shpesh, fillojnë edhe vetë t'u besojnë këtyre.

• **Ndjenjat janë vetëm – ndjenja.** Ato nuk janë të mira apo të këqija, të drejta ose të gabueshme, prandaj mos diskutoni me fëmijët kur ju tregojnë se çfarë ndiejnë. Mos i përjashtoni ndjenjat e tyre dhe mos i flakni si të parëndësishme. Mos i përqeshni, as mos i nënëçmoni.

• **Të dëgjosh, të dëgjosh, të dëgjosh!** Për të qenë një dëgjues i mirë, së pari patjetër duhet të doni të dëgjoni se çfarë kanë për t`ju thënë fëmijët tuaj dhe të besoni se ajo që thonë ata është e rëndësishme. Dëgjoni ndjenjat e tyre, jo vetëm fjalët. Nëpërmjet gjesteve, syve dhe kontaktit fizik, bëjani me dije se jeni duke dëgjuar. Shtroni pyetje për ta shpërfaqur interesimin tuaj a për të ndihmuar në qartësimin e ndonjë pike që të shmanget mosmarrëveshja. Nëpërmjet dëgjimit aktiv ju rritni vetëbesimin e fëmijës dhe vlerësimin për veten e tij.

• **Bëhuni kërkues.** Bëhuni të hapur që të diskutoni për çfarëdo teme për të cilën fëmija dëshiron të bisedojë. Në qoftë se dëshironi që fëmija juaj të marrë vendime të drejta e të moralshme, ai duhet të ketë informacione të bollshme për këtë.

• **Kontrollojeni tonin e zërit tuaj.** Vetëm sa do t`i irritoni edhe më tepër nëse bërtitni, kritikoni ose mbani ligjëratë.

• **Mos i mundoni edhe mos përsëritni të njëjtat kërkesa.** Përsëritja e së njëjtës gjë në vazhdimësi nuk do t`i bëjë fëmijët të dëgjueshëm. Shpjegojeni atë që kërkoni nga ta dhe tregojuni se përse atë e konsideroni të rëndësishme. Kujtojani atë fëmijës një herë ose dy. Në qoftë se nuk reagon, atëherë ndërmerrni masa përkatëse. Veçse duhet të jeni të sigurt se masa e ndërmarrë i përgjigjet asaj sjelljeje.

• **Qartësoni pritjet tuaja.** Fëmijët nuk i lexojnë mendimet, ata nuk mund të dinë se çka pritet nga ta përderisa nuk ua thonë këtë në mënyrë të qartë.

• **Nëse kritikoni, kufizohuni në sjelljen konkrete që nuk e miratoni.** Mos u bëni i paqartë. Sigurohuni nëse fëmija juaj e ka kuptuar se ju nuk keni asgjë kundër tij, por vetëm kundër sjelljes së tij. Për shembull: *“Jam zemëruar pse nuk e ke mbajtur fjalën që do të paraqitesh në qoftë se nuk do të mund të vish me kobë”* në vend të *“Jam i zemëruar tepër me ty”*.

• **Çdoherë kur gjykoni, kur jeni tepër të ngurtë ose ua ngushtoni hapësirën e lirë – ju vetëm sa i ndrydhni më fort, gjithnjë derisa nuk arrijnë në pikën kur nuk do të duan më të flasin me ju ose nuk do të duan më fare të jenë me ju.**

• **Përqëndrohuni vetëm në problemet e tanishme** dhe zgjidhni ato një nga një. Në qoftë se ju i rrin mbi kokë fëmijës çdoherë kur jeni nervoz, atëherë fëmija nuk do t`ju dëgjoj fare se çfarë po i thoni.

• **Kur fëmija ka problem,** humbja e durimit apo reagimi i ashpër vetëm sa e bën fëmijën tuaj të ndihet edhe më keq. Së pari ndëgjoheni atë; pastaj shprehni dashuri dhe mirëkuptim në vend të dhunës dhe nervozës. Disiplina e përshtatshme mund të zbatohet më vonë.

• **Respektojini mendimin e fëmijës,** edhe pse në të shumtën e rasteve do të jetë ndryshe nga mendimi juaj. (A nuk ka dalluar mendimi juaj nga mendimi i prindërve tuaj?).

- **Organizoni takime familjare** së paku njëherë në javë. Është ky një rast për t'u "pastruar ajri", duke i lejuar secilit të paraqesë pakënaqësitë, kërkesat dhe mendimet pa frikë nga pasojat. Këto takime mund t'i lirojnë ata nga çfarëdo tendosjesh, që është më mirë sesa të lihen që tendosjet të grumbullohen dhe të shpërthejnë në rastin e parë.

- **Le të na bëhet të dëgjuarit përparësi.** Ndani kohë që të jeni vetëm me fëmijën. Çdo gjë tjetër mësoni anash.

- **Kur shfaqet problemi,** së pari qartësojeni pjesëmarrjen tuaj në ngjarje apo në situatë, vendosni se i kujt është ai problem, pranoni gabimet në sjellje dhe pastaj shtroni dëshirat dhe kërkesat tuaja.

Disa këshilla me rëndësi gjatë intervistimit të viktimave të dhunës

- ❖ Nëse dhuna është raportuar në polici, duhet treguar kujdes për lajmërimin e koordinatorit të sistemit të referimit.
- ❖ Përpara intervistës, vlerësohet me kujdes riskun e intervistës dhe impaktin e saj mbi viktimën: gra të dhunuara tregojnë se bërja e intervistës në kushte e rrethana të papërshtatshme ndonjëherë e ka përkeqësuar situatën.
- ❖ Nëse është e mundur, punonjësi/sja i/e policisë që kryen intervistën me viktimën të jetë i të njëjtës gjini me të.
- ❖ Sigurohet që viktimë nuk do të ketë pasoja pas dhënies së deklaratës dhe pas largimit tënd. Bindet viktimën se siguria e saj është prioritet për policinë dhe se viktimë nuk është fajtorë.
- ❖ Policia me veprimet e saj duhet të fitojë besimin e viktimës në mënyrë që të jetë në gjendje të grumbullojë gjithë informacionin e duhur për të vazhduar hetimin deri në fund.



- ❖ Punonjësit e policisë nuk duhet të harrojnë që krimi, mund të jetë ngjarje rutinë për ta por jo për viktimën.
- ❖ Tregohet kujdes me tonin e zërit, shikimin dhe fjalët e përdorura: të gjitha këto duhet të demonstrojnë se punonjësit e policisë janë aty “për të kuptuar se çfarë ka ndodhur dhe ndihmuar, jo për të gjykuar”.
- ❖ Tregohet vëmendje dhe durim në marrjen e përgjigjeve: mbahet parasysh se viktimës mund t’i jetë thënë nga dhunuesi se, nëse kërkon ndihmë askush nuk do ta dëgjojë. Tregohet mirësjellje, maturi dhe racionalitet: viktimat tregojnë për raste gurrimi të ndërhyrjes së policisë për ndalimin e dhunuesit, që tregojnë mungesën e ndjeshmërisë së policisë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje.
- ❖ Tregohet mbështetje: demonstron me veprime e sjellje se për punonjësit e policisë ka shumë rëndësi siguria e viktimës. Ndihmohet të heqë frikën dhe të jetë gati për të bashkëpunuar me zbatuesit e ligjit. Duhet bërë viktimë që të ndjejë se deklarata e tij/saj është e rëndësishme.
- ❖ Fëmijët duhet të intervistohen në një mënyrë të përshtatshme për moshën e tyre, mundësisht vetëm. Edhe kur fëmijët nuk kanë qenë dëshmitarë të ngjarjes, por ishin prezent në dhomë, punonjësit e policisë duhet të:
 - Dokumentojnë emrat dhe moshën.
 - Dokumentojnë shenjat e traumës apo ndonjë plagë të abuzimit apo të traumës.
 - Të dokumentojnë deklarata nëse është e mundur.
- ❖ Kujdes! (Intervista me fëmijët duhet të bëhet vetëm në prani të psikologut ose nga punonjësi social).
- ❖ Intervista të bëhet në një vend të sigurt dhe konfidencial për fëmijën dhe mundësisht larg vendit ku ka ndodhur dhuna. Nëse mendohet se këto nuk garantohen atëherë shtyhet intervistën për një moment tjetër.
- ❖ Nuk duhet të dëgjohet prej prindërve dhe të tjerëve pjesëtarë të familjes ajo çka thuhet gjatë intervistës.
- ❖ Nëse fëmija nuk dëshiron të flasë, ai/ajo nuk duhet detyruar. Ndonjëherë kjo shkakton mbyllje në vetvete.
- ❖ Kujdes! Nuk i premtohen fëmijës gjëra për të cilat nuk mund të mbahen premtimet!

“ Shpesh herë dhuna ndodh në prezencë të fëmijëve. Fëmijët janë njëkohësisht dëshmitarë dhe viktimë të dhunës në familje. Edhe në rastet kur mbi ta duket se nuk ushtrohet ndonjë nga format e dhunës së drejtpërdrejtë, ndodh ajo që e quajmë dhunë e asistuar. Fëmijët viktimë të dhunës në familje kanë probleme psikologjike, mjekësore dhe të zhvillimit në përgjithësi. Ata humbasin vetëbesimin, kanë frikë, inatosen ose fajësojnë veten e tyre, kanë turp (shih shenjat e formave të ndryshme të dhunës dhe manifestimin e tyre tek fëmijët). ”

TRAJTIMI I FËMIJEVE VIKTIMA TË KEQTRAJTIMIT

Mbështetja psikosociale/ këshillimi psikosocial për fëmijët viktime të dhunes

Çfarë është mbështetja psikosociale?

Mbështetja psikosociale është mbështetje që ndihmon fëmijët, familjet dhe komunitetet për të përballuar krizën dhe për të përforcuar ose rifituar zhvillim psiko-social të shëndetshëm dhe elasticitet përballë rrethanave sfiduese.¹

Situatat në të cilat jepet mbështetje psikosociale janë emergjencat komplekse – që përfshijnë riintegrimin e fëmijëve të cilët janë asociuar me forca luftimi dhe fëmijët e tjerë të ndarë; në situata fatkeqësish natyrore që sjellin si pasojë zhvendosjen, humbjen e jetës apo ndarjen, në situata të HIV/AIDS edhe në kontekstin e mbështetjes së nevojshme si pjesë e procesit të testimin si edhe për fëmijët familjet dhe komunitetet që përballen me humbjen, vuajtjen, varfërinë në rritje dhe stigmën; në situatë kur fëmijët janë sulmuar seksualisht ose përdhunuar, trafikuar, torturuar ose janë institucionalizuar për një kohë të gjatë; në situata kur fëmijët kanë një sëmundje për një kohë të gjatë ose kur janë duke u shëruar nga dëmtime/ plagë të rënda. Sipas UNICEF, plotësimi i nevojave materiale dhe sociale, së bashku me plotësimin e nevojave për të qenë të sigurt, janë faktorë kyç në sigurimin e mirëqenies psikosociale dhe duhet të njihen si pjesë e Shërbimeve Psiko Sociale efektive. Aktivitete për të adresuar nevojat e fëmijëve - edukimi, masat mbrojtëse, kujdesi shëndetësor - duhet të ofrohen në mënyrë të tillë që të përmirësojnë dhe jo të dëmtojnë më tej mirëqenien psiko-sociale²

Çfarë është këshillimi psikosocial?

Këshillimi psikosocial është një shërbim i ofruar nga një këshillues profesionist për një individ, familje apo grup me qëllim përmirësimin e mirëqenies, lehtësimin e stresit dhe zgjerimin e aftësive të përballimit³ Shërbimet e këshillimit psikosocial zakonisht përfshijnë dallimin (screening), vlerësimin psikosocial, ndërhyrjen këshilluese bazuar në një plan të shërbimit të këshillimit dhe ndjekjen paskëshillim. (folloë up)⁴

¹<https://bettercarenetwork.org/sites/default/files/attachments/Programming%20for%20Psychosocial%20Support%20FAQs.pdf>

²<https://bettercarenetwork.org/sites/default/files/attachments/Programming%20for%20Psychosocial%20Support%20FAQs.pdf>

³http://www.floridahealth.gov/programs-and-services/childrens-health/healthy-start/_documents/hssg-chapter%20-9-revised-2010.pdf

⁴http://www.floridahealth.gov/programs-and-services/childrens-health/healthy-start/_documents/hssg-chapter%20-9-revised-2010.pdf

Këshillimi psiko- social konsiderohet i përshtatshëm për fëmijët në situata veçanërisht të vështira si : fëmijët që kanë qenë të abuzuar emcionalisht , fizikisht ose seksualisht; fëmijët që janë braktisur ose që kanë humbur; fëmijët që janë neglizhuar nga prindërit apo nga kujdestarët ; fëmijët që janë në burg së bashku me prindërit ose fëmijët që janë në burg; fëmijët në situatë rruge ; fëmijët viktimë të dhunës në familje; fëmijët që janë refugjatë; viktimat e fatkeqësive natyrore; fëmijët viktimë të punës së fëmijëve ; fëmijët në konflikt me ligjin; fëmijët me aftësi të kufizuara; fëmijët që janë prekur nga konflikti i armatosur; fëmijët që kanë qenë dëshmitarë të ngjarjeve traumatike⁵

Në këto situata këshillimi psikosocial është një ndërveprim midis një fëmije dhe /ose prindi dhe këshilluesit dhe ka për qëllim të ndihmojë fëmijën të ndryshojë , përmirësojë, zgjidhë sjelljen , problemet / vështirësinë apo paretinat që ka. Është procesi i të ndihmuarit të fëmijës të zbulojë mekanizmat që kanë qenë të dobishëm në të shkuarën dhe se si këto mekanizma mund të përdoren apo të modifikohen për situatën aktuale / të tanishme, ose se si të zhvillojë këto mekanizma nëse nuk i ka patur. Këshillimi psikosocial ka të bëjë me forcimin e aftësisë së fëmijës për të zgjidhur problemet dhe për të marrë vendime. Është ndryshe nga dhënia e këshillave. Në marrëdhënien e këshillimit psikosocial, këshilluesi nuk është një këshilltar ose person me autoritet të rreptë. Procesi përfshin një përgjegjësi të ndërsjellë mes këshilltarit që synon të respektojë dhe të ndjekë këndvështrimin e fëmijës, dhe fëmijës. Megjithatë, ekzistojnë dallime natyrore ‘fuqie’ midis këshilltarit, i cili është i rritur dhe fëmijës.

Këshillimi i mundëson fëmijës të shprehë emocione, shqetësime, mendime, frikë, etj. dhe synon të rivendosë ndjenjat e dinjitetit dhe të vetëvlerësimit. Fëmija ndihmohet për të gjetur zgjidhje (strategjitë e përballimit/aftësitë për zgjidhjen e problemeve) përmes dëgjimit, duke dhënë ndjeshmëri, duke qenë mbështetës dhe mirëkuptues. Vetë diskutimi i problemeve në detaje ka shpesh një efekt qartësues nga ku mund të gjenden zgjidhje⁶

Përgjegjësitë dhe funksionet e këshilluesit psikosocial

Funksionet e këshilluesit psikosocial janë që : a) të ndihmojë aktorët e mbrojtjes së fëmijëve dhe komunitetin në identifikimin e fëmijëve që kanë nevojë për këshillim/ që duhet të përfitojnë nga ndërhyrjet këshilluese; b) të punojë me ekipin multidisiplinar të mbrojtjes së fëmijës; c) të vendosë kontakt dhe ndërveprim me komunitetin dhe mjedisin social të fëmijëve si edhe të kërkojë dhe të vendosë besimin e komunitetit; d) të nisë dhe të kryejë këshillimin për fëmijët me probleme (psikosociale), brenda kontekstit të normave sociale dhe kulturore dhe traditave. e) të vlerësojë progresin në sesione duke dokumentuar çdo sesion.⁷ f) Të shërbejë si një model i mirë të rrituri për fëmijën – të jetë një person nga i cili fëmija mund të mësojë shprehje sociale, qëndrime, sjellje , vlera, strategji etj.. g) Të ndjekë fëmijët që kanë kaluar përmes këshillimit, pasi këshillimi ka përfunduar

Parimet e Këshillimit Psikosocial të fëmijëve

- Pranimi i fëmijës dhe besimi tek fëmija:
- Vendosja e një marrëdhënieje të tillë që fëmija të ndjehet totalisht i lirë të shprehë ndjenjat e veta, të ndjehet rehat që të jetë vetvetja në veprimet komunikimet dhe reflektimet e tij/saj;
- Dallimi i ndjenjave të shprehura të fëmijës dhe reflektimi i tyre në mënyrë që fëmija të kuptojë arsyet e sjelljeve të veta dhe të ndjehet i/e kuptuar dhe i/e mbështetur emcionalisht;
- Empatia: të kuptuarit e ndjenjave, sjelljeve nevojave të fëmijës prej pikëpamjes së tij/saj dhe jo prej pikëpamjes së këshilluesit;

⁵<http://docplayer.net/41792991-General-manual-on-psychosocial-counselling-for-children-in-especially-difficult-circumstances-third-edition.html>

⁶<http://docplayer.net/41792991-General-manual-on-psychosocial-counselling-for-children-in-especially-difficult-circumstances-third-edition.html>

⁷ Kjo do të jetë gjithashtu e dobishme për planifikimin, krijimin e një pamje të situatës, mbikëqyrjen dhe punën në ekip.

- Mbrojtja: fëmija duhet të trajtohet në mënyrë të tillë që të ndjehet që është i /e mbrojtur se ai/ ajo nuk është vetëm në zgjidhjen e problemeve të tij/saj të vështira. Fëmija duhet të kuptojë që këshilluesi është gati të ofrojë siguri derisa fëmija është i aftë të përmirësojë marrëdhëniet me njerëz të rëndësishëm të jetës së tij (me rrjetin e vet social);
- Lejimi dhe inkurajimi i fëmijës që të eksplorojë problemet e veta dhe të ndërgjegjësohet për kapacitetet e veta . Këshillimi duhet të fokusohet në zhvillimin e këtyre kapaciteteve . Fëmija duhet lejuar që të provojë zgjidhjet e zgjedhura prej vetë atij/asaj dhe duhet mbështetur në procesin e zgjidhjes. Roli i këshilluesit nuk është që të japë këshilla , por që nëpërmjet të dëgjuarit , roleve , brainstorming t'i japë mundësi fëmijës të vendosë se çfarë është më e mira si zgjidhje;
- Është e rëndësishme që këshilluesi të mos e humbasë përqëndrimin në qëllimin e këshillimit – në ndjenjat dhe dilemat më destabilizuese për fëmijën -në rastin e fëmijës së keqtrajtuar apo fëmijës viktimë e keqtrajtimit apo abuzimit seksual p.sh është që këshilluesi duhet t'i bëjë fëmijët që të ndjehen se se nuk është faji i tyre. Fëmijët duhet të ndjejnë që ata janë viktima të të rriturve . Mungesa e mbrojtjes prej të rriturve është arsyeja pse fëmijët vuajnë;
- Fëmijët që raportojnë abuzimin neglizhimin apo shfrytëzimin duhet të të respektohen gjithmonë. Nëse mundohesh të gjykosh e të vendosësh nëse ngjarjet kanë ndodhur apo jo nuk do ta mbrosh dot fëmijën dhe nuk mund të vendosësh marrëdhëniet e duhura.
- Duhet kuptuar që në këshillim duhet menduar çfarë mund të bëjë dhe çfarë mund të mos jetë në gjendje të bëjë fëmija për të zgjidhur një problem apo vështirësi dhe duhet besuar në kapacitet e fëmijës;
- Fëmijët duhet të merren seriozisht në çdo kohë, edhe pse historitë e tyre mund të duken të çuditshme, joreale dhe pa kuptim. Historia e fëmijës mund të jetë mënyra e tij/saj për të shprehur ose ndarë diçka. Fëmija do të ndihet i respektuar, i dëgjuar dhe nuk do të ndjejë se po përpiqeni të nënvlerësoni problemet e tij/saj;
- Fëmija duhet shpërblyer për çdo mendim e ndryshim pozitiv në procesin e këshillimit . Kjo do ta nxisë fëmijën që në të ardhmen të bëjë hapat e duhura dhe njokohësisht do t'i përmirësojë vetëvlerësimin;
- Duhet mënjanuar çdo lloj diskriminimi gjatë sesioneve të këshillimit;
- Këshilluesi duhet të jetë vetvetja i vërtetë duhet të sigurohet që është i ekuilibruar emocionalisht dhe psikologjikisht;

Aftësitë e Këshilluesit:

1. Aftësitë për të përmbledhur çfarë është thënë

Këshilluesi duhet të jetë i aftë të bëjë një përmbledhje të shkurtër pas çdo teme ose pjesë bisede. Përmbledhja nuk duhet të jetë përsëritje si papagall e asaj që fëmija ka thënë – përmbledhja duhet të përqëndrohet tek mesazhet kryesore dhe te ndjenjat që fëmija ka shprehur. Përmbledhja ka të bëjë me riparazitjen dhe lidhjen e aspekteve, ndjenjave dhe temave përkatëse të pjesës. Kjo sepse:

- Është e rëndësishme të kontrolloni nëse ju, si dëgjues, e keni kuptuar mesazhin.
- Përmbledhja e bën fëmijën të ndiejë se ju po dëgjoni dhe jeni të interesuar.
- Gjatë këshillimit shkëmbehet shumë informacion-përmbledhja bën të mundur edhe një strukturim të komunikimit, qoftë për këshilluesin

- Përmbledhja e inkurajon fëmijën të vazhdojë më tej në tregimin e historisë së
- Përmbledhja mbush boshllëqet dhe i jep drejtim një bisede që ose “ka ngecur” ose “ nuk po shkon kurrkund” . Këshilluesi e fillon përmbledhjen me : nëse e kuptobva mirë, po thua që ...

Përmbledhja është një teknikë e dobishme për:


- Sqarim
- Për të përmbledhur problemin / situatën e fëmijës;
- Për të filluar dhe mbyllur sesionet e këshillimit;
- Për të ënë në dukje zbulime të rëndësishme;
- Për të krijuar një pamje më të gjerë- duke lidhur idetë dhe ndjenjat e shprehura brenda një sesioni dhe në sesione të ndryshme;

2. *Aftësia për të reflektuar ndjenjat*

Reflektimet e ndjenjave janë rithënia me fjalë të ndryshme e mesazhit të përcjellë nga fëmija. Këshilluesi përqendrohet në ndjenjat e shprehura ose në kuptimin e mesazhit. Reflektimet e ndjenjave i referohen kështu metodës së rifrazimit të një pjese të diçkaje që është thënë siç janë fjalët që shprehin ndjenja, ndjenjave të shprehura pa fjalë/ në mënyrë joverbale, ose fjalëve me ngarkesë emocionale. P.sh: Kur këshilluesi dëgjon fëmijën të thotë : “ Kur dëgjova që shoku im që mëson aq shumë nuk e mori provimin, u shokova” , ai reflekton ndjenjën e frikës duke thënë : “ ke frikë se nuk e merr dot provimin “ ose kur fëmija thotë: “ shoku nuk më flet më sepse kujton se ia nxora unë sekretin” , Këshilluesi thotë : “ ti je i zhgënjyer prej shokut “ Reflektimi i ndjenjave ndihmon të krijohet një ambjent i shëndetshëm emocional, përcjell se këshilluesi e kuptoi fëmijën dhe e ndihmon fëmijën të jetë në kontakt me ndjenjat e tij.

3. *Aftësia për të parafrazuar*

Parafrazimi do të thotë rithënie me fjalët e këshilluesit të përmbajtjes apo thelbit të mesazhit që thotë fëmija. Edhe parafrazimi është i rëndësishëm për të verifikuar dhe përcjellë të kuptuarin e këshilluesit mbi atë që ka thënë fëmija dhe inkurajon fëmijën që të vazhdojë të flasi mbi çështjen që është parafrazuar.



4. *Aftësia për të përsëritur fjalët kyçe*

Kjo ka të bëjë me jehonën drejtpërdrejt të frazave ose disa fjalëve që fëmija ka thënë për të nxjerrë në pah një aspekt të caktuar të përvojës së tij. Duke përsëritur, këshilluesi inkurajon fëmijën të vazhdojë të flasë, dhe përcjell se është duke e dëgjuar. P.sh, nëse fëmija thotë : “ isha tek gjyshja dhe ajo më qortoi se nuk po sillem mirë me vëllain” këshilluesi thotë: “ ajo te qortoi...” . Në momentin që këshilluesi jehon pjesë të frazave të fëmijës ose disa fjalë që ka thënë për të nxjerrë në pah një aspekt të eksperiencës së fëmijës, fëmija inkurajohet të flasë dhe shprehë që këshilluesi po e dëgjon me vëmendje.

5. *Aftësia për të dëgjuar aktivisht - komunikimi dhe disponueshmëria joverbale.*

Është një mënyrë për t'i dhënë vëmendje fëmijës, situatës dhe ndjenjave të tij. Ka të bëjë me disa aftësi bazë të këshillimit. Kjo aftësi e drejton këshilluesin psikologjikisht dhe fizikisht drejt fëmijës. E bën fëmijën të marrë një pozicion thellimi dhe analiza ndaj problemit që ka. Të dëgjuarit aktiv përmbledh dhe dëgjuarin e mesazheve verbal , perceptimin e komunikimit joverbal dhe përgjigjen ndaj të dyjave. Komunikimi joverbal mund të jetë shprehja e fytyrës , pozicioni qëndrimit ulur , heshtja , xhestet me duar, tundja e kokës në shenjë pohimi , pasthirrmat ëhë , ah, vërtet, oh, ooo, po, dhe shprehjet “e kuptoj” , “e shoh” . Të gjitha këto tregojnë që këshilluesi po dëgjon dhe po e udhëheq dhe inkurajon bisedën, që nuk është se thjesht po i hyjnë në vesh por po dëgjon me gjithë vëmendjen , trupin dhe ndjenjat e veta, Do të thotë që këshilluesi dëgjon me kujdes çfarë po thotë fëmija çfarë po mundohet të komunikojë dhe të kuptojë çfarë do të thotë në të vërtetë dhe ta pasqyrojë përsëri te fëmija. Kjo do të thotë që të mundohesh të kuptosh thelbin e mesazheve që po shprehen. Një këshillues mund të bëhet dëgjues aktiv duke përdorur aftësitë e kujdesit , komunikimit joverbal, përmbledhjes dhe përsëritjes së fjalëve kyçe. Të dëgjuarit aktiv jep mundësinë e : të treguarit fëmijës që këshilluesi po e dëgjon (po I jep vëmendje); Të treguarit fëmijës që ju po dëgjoni me kujdes; verifikimin nëse e kuptuara e këshilluesit për atë që thotë fëmija është konsistente me atë që ka dashur të thotë fëmija; këshilluesi të japë përgjigje lidhur me shqetësimet e shprehura të fëmijës duke përfunduar ndërgjegjësimin e tij për mendimet dhe duke sqaruar ndjenjat e tij, arsyet për ndryshimin e sjelljes; lehtësimin dhe stimulimin e komunikimit dhe shprehjes

6. *Empatia*

Empatia është një formë e komunikimit njerëzor që përfshin të dëgjuarin e fëmijës, të kuptuarin e shqetësimeve të tij/ saj, të komunikuarin e të kuptuarit tek fëmija. Ka të bëjë me shprehjen e të kuptuarit nga ana e këshilluesit e të kuptuarit të ndjenjave të fëmijës: Këshilluesi I thotë fëmijës: “ndjen këtë emocion sepse ...”. Empatia mund të përcillet edhe nëpërmjet aftësive të tjera si parafrazimi, përmbledhja dhe pyetjet. Empatia përcaktohet si aftësia për ta vënë veten në vend të tjetrit: të pyesësh: si është të jesh në pozitën e tij ? dhe ta komunikosh këtë. Empatia ndryshon nga simpatia. Nëse ndjen simpati , këshilluesi mund të marrë anë dhe kjo do të shtrembërojë ose do të afektojë aftësinë e tij për të dëgjuar të gjithë historinë lidhur me problemin. Për shembull, nëse këshilluesi qan së bashku me fëmijën sepse simpatizohet me problemin, kjo mund të bëjë që këshilluesit të mos vërë re që keqardhja për veten nuk e lejon fëmijën që të ndërmarrë forma më konstruktive të veprimit. Në të njëjtën kohë, mund të jetë e rëndësishme që këshilluesi të shprehë që historia e fëmijës po e ndikon atë, megjithatë duhet mbajtur distanca e nevojshme emocionale për të qenë në gjendje për të përmbledhur apo strukturuar situatën tek fëmija. Empatia nuk do të thotë që këshilluesi bie dakord me fëmijën. Ajo ka të bëjë me të pranuarin e pikëpamjeve të tij dhe në interesimin për të kuptuar implikimet që ka perspektiva e fëmijës në sjelljen e tij.

7. *Aftësia për të formuluar pyetje me fund të hapur*

Fëmijës i duhen bërë pyetje që do të inkurajojnë vazhdimin e diskutimit. Këto pyetje janë esenciale në këshillim. Pyetjet e hapura e aftësojnë fëmijën që të japë përgjigje të përgjithshme me fjalët e tij , duke stimuluar kështu fëmijën që të strukturojë mendimet e tij/ saj. Pyetjeve të hapura nuk mund t'ju përgjigjesh

me pak fjalë ose thjesht me “po” “jo”. Ato fillojnë me si, çfarë, pse etj..

Pyetjet e mbyllura kufizojnë përgjigjet dhe procesin e ndërveprimit , megjithatë janë të dobishme për të marrë informacion specifik. Këshilluesi nuk duhet të bjerë në kurthin e bërjes së pyetjeve sugjестive. Këto pyetje sugjerojnë një përgjigje specifike dhe drejtojnë bisedën. Këto pyetje duhet të mënjahen gjithmonë sepse ato reflektojnë idetë dhe qëndrimet e këshilluesit dhe jo ato të fëmijës. Këshilluesi nuk duhet të bëjë shumë pyetje që fillojnë me “pse “sepse këto mund të tingëllojnë si akuza dhe rezultojnë shpesh në qëndrim mbrojtës dhe të tërhequr të fëmijës. Një shembull I pyetjes së hapur është “ Cfarë mendon për shkollën? “ndërsa një pyetje e mbyllur është “Mendon pozitivisht apo negativisht për shkollën?” . Pyetje sugjестive janë p.sh: “Ty të pëlqen shkolla apo jo? “

8. *Aftësitë për tu lidhur me fëmijën*

Lidhja me njerëzit përfshin:

- Të pranuarit e njërvëzve ashtu siç janë
- Të kuptuarit dhe të pranuarit e prejardhjes kulturore dhe gjenetike
- Këshilluesit duhet të kenë një qasje respekti dhe pranimi
- Mbrojtja e konfidencialitetit të sesioneve të këshillimit
- Lejimi dhe inkurajimi që fëmija të marrë pjesë dhe të bëhet i vendosur në planin e tij/ saj të veprimit
- Të dëgjuarit dhe të respektuarit e opinionëve dhe perspektivave të fëmijës
- Të dhënit fëmijës mundësisë që të bëjë pyetje dhe të kërkojë sqarime nga këshilluesi
- Të përdorurit e një gjuhe që është e përshtatshme dhe e pranueshme për nivelin e arsimit dhe zhvillimit të fëmijës;

9. *Aftësitë në observimin e fëmijës*

- Këshilluesi duhet të jetë i ndjeshëm ndaj shprehjes së fytyrës lëvizjeve të trupit dhe paraqitjes fizike të fëmijës. Këto tregojnë kuptimin dhe arsyet pse fëmija ka tension gjatë këshillimit. Megjithatë, është shumë e rëndësishme të diferencosh mes çfarë është shprehur direkt dhe çfarë nuk është shprehur direkt

10. *Aftësitë në menjanimin e gjykimeve*

Çelësi për një qasje empatike është që të mënjahet të qenit paragjykes ose komunikimin e përgjigjeve vlerësuese. Këshilluesi duhet të kuptojë si është për fëmijën që si është të jetë në atë situatë që është jo si duhet të jetë. Qëndrime pragjykesë që duhen shmangur janë:

- Dhënia e urdhrave dhe komandave fëmijës lidhur me çfarë duhet të bëjë;
- Paralajmërimi apo kërcënimi
- Dhënia e këshillave apo dhënia e zgjidhjeve
- Argumentimi ose bindja e fëmijës për të bërë diçka që ai mund të mos dojë të bëjë;
- Moralizimi

- Mosrënia dakord, gjykimi ose kritika e fëmijëve për sjelljen dhe vendimin e tyre
- Tallja e fëmijës ose etiketimi negativ i tyre
- Interpretimi ose analiza, pa komunikuar ose pa i verifikuar këto mendime me fëmijën
- Sigurimi apo bërja e premtimeve që nuk mund të mbahen .
- Simpatizimi me fëmijën

11. *Aftësitë për t'u marrë me hezitimin*

Nganjëherë fëmijët mund të mos duan të flasin , ata mënjanojnë disa tema, janë të heshtur etj.. Kjo sjellje mund të jetë një përgjigje për përmbajtjen dhe stilin e komunikimit mes këshilluesit dhe fëmijës. Fëmija mund të hezitojë në lidhje një teme apo në lidhje me gjithë procesin e këshillimit. Për këtë arsye është e rëndësishme që:

Të mënjanohet konfrontimi ose forcimi i hezitimit

Sa më shumë që fëmija nuk do të të flasë , aq më pak shanse ka që ai të ndryshojë sjelljen apo situatën e tij (hezitimi për të folur është shpesh një mënyrë për të shprehur kufizimet e veta). Këshilluesi duhet të përpiqet të krijojë një atmosferë të besimit dhe kujdesit

Të përdoren teknika indirekte si vizatimi shkrimi apo piktura për ta bërë fëmijën të flasë Duhet rënë dakord për hapa të vogla të arritshme kollaj për ta zgjidhur hezitimin

Duhet kaluar në një temë më pak të vështirë dhe nëse hezitimi vazhdon , kjo mund të jetë një arsye e mirë për të ndaluar procesin

Mund të jetë e dobishme që të flitet për sjelljen hezituese

Duhet kontaktuar një person i rëndësishëm në ambjentin e fëmijës për të ndihmuar . duhet mbajtur parasysh që të respektohet pikëpamja e fëmijës dhe të flitet me të për një zgjidhje. Në mënyrë që të kuptohen më mirë ambivalencat me të cilat disa fëmijë vijnë në këshillim duhet mbajtur parasysh që:

- Disa fëmijë mund të jenë detyruar nga dikush që të vijnë në seancat e këshillimit;
- Fëmijët mund të besojnë që ndërhyrje të tjera psikosociale janë më të përshtatshme për të;
- Mund të kenë vetëvlerësim të ulët dhe pak besim në aftësitë e veta për të ndryshuar;
- Mbase nuk ndjehet mirë për të ndjekur seancat e këshillimit;
- I mungon besimi tek personaliteti i këshilluesit apo figura e këshilluesit si figurë të rrituri;
- Mund të ketë një bllokim emocional që e bën shumë të vështirë ose shumë konfrontuese për të folur apo përballuar situatën e tij;
- Mund të ketë frikë konsekuencat e ndarjes së informacionit dhe konsekuencat dhe reagimeve të jashtme;
- Mund të ketë frikë të shprehë veten ose mund edhe të mos ketë nevojë të shprehë veten për shkak të besimit;

12. *Aftësitë për tu marrë me emocionet*

Një nga elementët kryesorë të këshillimit është që është një vend për të shprehur emocionet. Këto emocione shpesh luajnë një rol të rëndësishëm në sjelljen apo situatën të identifikuar nga fëmija apo të tjerët si problematike. Emocionet si frika zemërimi dhe sikleti mund të shfaqen në tipare sjelljeje si paretat fizike, vështirësia në vendim-marrje , imazh apo besime të gabuara për veten. Fëmija duhet të merret me këto emocione në mënyrë që të ndryshojë. Kjo ka të bëjë me shprehjen e hapur dhe eksplorimin e këtyre emocioneve si edhe të kuptuarin e tyre, të pranuarin dhe gjetjen e mënyrave për tu marrë me to. Këshilluesi duhet që aktivisht të udhëheqë fëmijën për të eksploruar ndjenjat e tij, t'i japë atij leje për ta bërë këtë dhe ta inkurajojë të shprehë emocionet. Kjo duhet bërë pa e shtyrë fëmijën dhe gjithmonë duke respektuar zgjedhjet e tij. Për ta bërë fëmijën që të besojë dhe të ndajë informacion duhet durim dhe atmosfera e duhur.

13. *Aftësitë e zgjidhjes së problemeve*

Aftësitë që e bëjnë këshilluesin të ndihmojë fëmijën për të gjetur zgjidhje për situatën problematike janë:

- a- Aftësia për të kthyer pritjet e fëmijës në qëllime të arritshme – Për t'i dhënë fëmijës fokus për përqëndrimin, veprimin, vullnetin, angazhimin , motivimin etj.;
- b- Aftësia për të përpunuar qëllimet: për të specifikuar qëllime që janë shumë të përgjithshme për tu zbatuar; për t'i eksploruar qëllimet më në thellësi; prioritetizuar me cilat qëllime duhet punuar në fillim.
- c- Aftësia për ta përfshirë fëmijën në diskutimin e cili problem duhet zgjidhur i pari diskutimi i zgjidhjeve, eksplorimin e zgjidhjeve të mëparshme; përforsimin e zgjidhjeve të shëndetshme

KONSIDERATA PËR SITUATA TË VEÇANTA

Çfarë duhet mbajtur parasysh në këshillim nëse fëmija është abuzuar seksualisht

- Këshilluesi duhet *të ketë pasur eksperiencë të mëparshme* me viktime të abuzimit seksual;
- Nuk duhet të ekzistojë presioni i kohës-*duhet të merret kohë të vendoset një marrëdhënie besimi*;
- Nëse është e mundur, fëmija duhet observuar në ambjentin e shtëpisë;
- *Duben përdorur teknika si pikturat loja kukullat*
- Fëmijës *nuk i duhet kërkuar shumë informacion*. Ai duhet lënë që të vendosë vetë çfarë do të thotë dhe kur
- *Duhet reflektuar në mënyrë të sigurtë emocionin dhe të kuptuarit e asaj që shpreh fëmija*
- Është e rëndësishme *të thuhet që kurrë nuk është faj i fëmijës*;
- Duhet mbajtur gjithmonë parasysh dhe *nuk duhet nënvlehtësuar që fëmija përjeton ndjenja faji* që po e tradhëton abuzuesin. Fëmija ka frikë prej hakmarrjes së abuzuesit dhe njëkohësisht ndjenja faji
- Situatës / ngjarjes duhet me iu afri me hapa të vegjël, është vështirësia që ka fëmija që duhet të udhëheqë. Për të parandaluar bllokimin e fëmijës *sugjeroji fëmijës të përdorë një fjalë për abuzimin “ngjarja”, “ajo gjëja”*
- Fëmija mund të ketë një nivel të lartë ankthi – ai mund të jetë nervoz për këshillimin, mund të jetë nervoz për zbulimin që do të bëjë etj.. Duhet *te merremi me ankthin e fëmijës përpara se të merremi me problemin*- duhet të përdoren teknika relaksuese , pyetje rreth gjërave të tjera (gjërave të këndshme), këshilluesi flet pak për veten e vet
- Gjatë gjithë procesit të këshillimit *duhet punuar me vetëvlerësimin, me vetëbesimin dhe shprehitë sociale*
- Në rastet kur fëmija duhet të dëshmojë në gjyq duhet patur parasysh që edhe vetë pritja mund të shkaktojë stres psikologjik te fëmija dhe që sjellja e përfaqësuesve ligjorë ka traumatizuar shumë viktime fëmijë. Për këtë arsye është e nevojshme që : *të jepet mbështetje e vazhdueshme emocionale sidomos në kohën e vendimit*; të zhvillohet një takim para gjyqit; të familjarizohet fëmija me sallën e gjyqit para seancës ; të zhvillohet seanca me dyer të mbyllura;
- Duhet *të bëhet kujdes që fëmija ndjehet i lirshëm të flasë*- për këtë është e rëndësishme edhe atmosfera e këshillimit edhe gjinia e këshilluesit. Këshilluesi duhet të mbajë parasysh që ndjenjat e keqardhjes, pafuqisë apo përbuzjes nuk duhet të shprehen sepse e shtojnë ndjenjën e fajit tek fëmija . Fokusi duhet të jetë emocionet e fëmijës dhe duhet me iu përmbajt qëllimeve të këshillimit dhe planit të këshillimit
- *Distanca dhe afrimi për të folur për ngjarjen*: Duhet të mbahet parasysh se në abuzimin seksual, nuk është pyetur për kufijtë personalë të fëmijës. Do duhet që këta kufij të rizbulohen dhe për këtë duhet kohë- një kohë duhet që fëmija të afrohet në bisedë me këshilluesin dhe një kohë Akoma

më e gjatë për të folur për 'ngjarjen'. Fëmija duhet të eksplorojë vetë distancën personale dhe qasjen dhe këshilluesi shërben si test për fëmijën.

- **Fëmija mund të jetë i frikësuar:** Abuzuesi, i thotë fëmijës të mos i thotë asgjë askujt dhe shpesh e kërcënon fëmijën. Hapja te këshilluesi mundet të sjellë frikë, të cilën këshilluesi duhet ta njohi dhe ta trajtojë. Duhet mbajtur parasysh që fëmija mund të ketë frikë se abuzimi përsëritet
- **Fëmija mund të ketë njenja faji:** Fëmija mund të përjetojë ndjenja faji për shkak se: Është duke folur me këshilluesin dhe duke zbuluar një sekret; Akti i abuzimit i ka ndodhur pikërisht atij/asaj; Ka ndjesinë se po tradhton- kjo është e fortë veçanërisht në rast incesti; Mund të ndiejë se abuzimi ishte faji i tij/saj.
- **Fëmija mund të ndihet i turpëruar:** Ndjenjat e turpërimit për atë që ai/ajo duhej t'i nënshtrohej ose të ndërmerre janë pothuajse të pashmangshme. Ashtu si me emocionet e tjera, fëmija duhet të lejohet t'i nxjerrë jashtë/ t'i shprehë këto ndjenja. Mund të ketë ndjenja turpi për shkak të: ndjesisë së eksitimit /ose kënaqësisë që mund të ketë përjetuar gjatë ngjarjes; se prindërit janë disfunktionale; ndjehet i/e pisët dhe i/e padenjë; ndjehet se ka qenë ai/ajo vetë që ka shkaktuar abuzimin. Këto ndjenja duhet të pranohen dhe të shpjegohen- p.sh. që eksitimi dhe kënaqësia është e pakontrollueshme, që ajo që ka ndodhur nuk është për faj të fëmijës por sepse të rriturit nuk e kanë mbrojtur atë
- **Ndjehet i zemëruar:** Ndjenjat e zemërimit shpesh do të vijnë shumë më vonë gjatë procesit. Ky është një reagim i shëndetshëm, i cili duhet shprehur dhe trajtuar në këshillim. Mënyrat e duhura për të shprehur dhe menaxhuar zemërimin janë: Shkrimi i ditarit; Vizatimi; Piktura; Shkrimi i letrave; Teknikat e relaksimit; Ushtrime fizike
- **Ndjehet i vetmuar:** Fëmija mund të përjetojë ndjenjën e humbjes dhe më pas ndjenjën e vetmisë sidomos kur dhunuesi është dikush nga rrethi i ngushtë i fëmijës (p.sh. prindërit). Për më tepër, fëmija shpesh ka qenë vetëm me situatën (sekretin) dhe ndihet i tjetërsuar/ndryshe nga të gjithë. Ndjenja e vetmisë është një temë e mirë për të filluar sepse është një temë «më e lehtë» dhe mund të jetë një hyrje e mirë në temat e tjera / ndjenjat e tjera më të vështira për fëmijën
- **Ndjenja pozitive dhe negative ndaj dhunuesit:** Fëmijët kanë nevojë të dallojnë dhe të shprehin ndjenjat që kanë lidhur me dhunuesin, pozitive dhe negative qoftë për abuzimin seksual brenda familjes qoftë për atë jashtë familjes. Një teknikë e mirë është të pyesësh fëmijën të shkruajë ndjenjat që ka për abuzuesin. P.sh një baba mund të jetë një abuzues por njëkohësisht edhe prindi që kujdeset më shumë për fëmijët. Ta bësh fëmijën të besojë që seksi është një mënyrë e shprehjes së dashurisë prindërore do të thotë të përsëritësh këtë tradhëti. Fëmija ka nevojë ta menaxhojë zemërimin e tij. Fëmija duhet ndihmuar të shohë ndryshimin midis kontaktit fizik dhe dashurisë. Detyra e këshilluesit është të trajtojë siç duhet këto ndjenja marrëdhënie dashuri-urrejtje. Fëmijës duhet t'i theksohet qartë se seksi mes një të rrituri dhe një fëmije nuk është një shprehje dashurie por një krim dhe i ndaluar me ligj.
- **Ndjenja pozitive dhe negative ndaj prindit jo dhunues** Në rastet e incestit, marrja me ndjenjat ndaj palës që nuk është abuzuese është po aq e rëndësishme sa marrja me ndjenjat ndaj abuzuesit. Ndonjëherë viktimat janë më të zemëruara me këtë prind sesa me prindin abuzues. Nuk ka rëndësi nëse prindi jo abuzues (më shpesh nëna) e ka ditur për abuzimin apo jo- fëmija e fajëson atë që nuk e ka mbrojtur atë në kohën e abuzimit, edhe nëse ky prind nuk ka qenë në shtëpi gjatë kohës kur ka ndodhur abuzimi. Zemërimi i fëmijës mund të jetë më i fortë kur prindi jo abuzues mohon abuzimin seksual të kryer nga prindi tjetër. Zakonisht është më e vështirë që fëmijët të shprehin zemërimin ndaj prindit jo ofendues nëse fëmija është ende duke jetuar me të. Fëmijët

mund të kenë frikë nga hakmarrja dhe refuzimi i mëtejshëm. Në këto raste, fëmija duhet të ndahet përkohësisht nga ai prind derisa këto ndjenja negative të zgjidhen nëpërmjet: Takimit ballë për ballë me prindin dhe fëmijën për të zgjidhur këtë problem/ këtë ndjenjë; Shkrimin të një letre lidhur me ndjenjat e inatit ndaj tij/saj.

- **Marrëdhëniet me shokët/ bashkëmoshatarët** Ndjenjat e turpërimit janë shumë të rëndësishme në rastet e abuzimit seksual të fëmijëve. Marrëdhëniet me bashkëmoshatarët janë gjëja më e rëndësishme për një fëmijë në rritje, veçanërisht për një adoleshent dhe këto marrëdhënie duhet të mbahen edhe pas zbulimit të abuzimit seksual. Me miratimin e fëmijës, këshilluesi mundet që të ndihmojë në inkurajimin e ruajtjes së marrëdhënieve sociale duke: takuar personalisht miqtë e fëmijës në shkollë dhe në komunitet për t'i inkurajuar ata që të vazhdojnë të mbështesin fëmijën (gjatë takimeve duhet theksuar se nuk ishte faji i fëmijës); biseduar me prindërit/mësuesit e fëmijës për t'i inkurajuar ata të lejojnë bashkëmoshatarët e fëmijës ta vizitojnë fëmijën. Këshilluesi duhet ta nxisë fëmijën të shkruajë letra për miqtë, të takojë bashkëmoshatarë të rinj në grupe të shëndetshme.
- **Vetëvlerësimi** Forcimi i vetëvlerësimit të fëmijës është një element i rëndësishëm i këshillimit sepse fëmijët që abuzohen seksualisht shpesh kanë vetëbesim të ulët. Mënyrat se si mund të rrisni ndjenjat pozitive të fëmijëve për veten janë: lëvdojini ata për të gjitha sjelljet e tyre të përshtatshme ose pozitive; kritikoni sa më pak të jetë e mundur; mos e krahasoni sjelljen e tyre me atë të të tjerëve; gjeni aktivitete në të cilat ata shkëlqejnë dhe krijoni mundësinë që fëmija t'i kryejë këto, ose aktivitete me një faktor suksesi; mbani pritshmëritë realiste; Vlerësoni përpjekjet për të bërë detyrat jo vetëm përfundimin e detyrave; Ndani detyrat në komponentë të vegjël të menaxhueshëm.

KËSHILLIMI ME FËMIJËT ME SJELLJE SUICIDALE

Sipas OBSH-së, vetëvrasja është shkak i katërt kryesor i vdekjeve në fëmijët 15-19 vjeç⁸

Në 90% të vdekjeve të fëmijëve dhe adoleshentëve nga vetëvrasja është identifikuar si shkaktar rrënjësor një sëmundje mendore: çrregullim i humorit, çrregullimet e ankthit, abuzimi me substanca, dhe çrregullimi i sjelljes prishëse⁹

Shenjat që fëmija ka tendenca suicidale

- Në mënyrë spontane i vjen dëshira që të vdesë apo të iki nga kjo jetë;
- Disfori e rritur, teka, simptoma depressive , të ndjerët pa shpresë, i pandihmë, i cënueshëm;
- Vetëvlerësim i ulët;
- Përfshihet në aksidente të vogla;
- Përdor shprehje si “ nuk duroj dot më” “ Dua të vdes” ose “ dua të bien ë gjumë dhe të mos zgjohem më “ ;
- Largim nga kontrolli i pjesëtarëve të familjes apo shokëve;
- Eksperiencia të shtytjes prej apo humbjes së një personi të dashur apo të rëndësishëm;
- Dështim dhe ndjenjë e të qenit pa vlerë;
- Përdorimi i substancave kërcënuese për jetën;
- Abuzim i mbështetjes sociale;
- E folur allogjike dhe kaotike;
- Probleme me identitetin gjinor;

⁸ <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/suicide>

⁹ http://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/43487/9241594314_eng.pdf;jsessionid=FAD00C034FC2E-74CAFF22779B789DA3E?sequence=1



Në këshillimin e fëmijëve duhet patur parasysht që:

Të njihen tendencat suicidale të fëmijës Hapi i parë është njohja e tendencave suicidale të fëmijës. Fëmija mund të mos japë shenja të qarta që ai është suicidal. Në rast se dyshoni se fëmija ka tendenca të tilla e pyesni për të sqaruar situatën.

Pranimi: Problemi kryesor në bisedat rreth vetëvrasjes është të pranosh dëshirën e fëmijës. Nëse këshilluesi fokusohet në zgjidhjet apo rrugëdaljet, kjo mund të thotë që ai po e sheh situatën nga pika e vet dhe nuk po e kupton fare fëmijën. Të pranuarit i jep fëmijës një ndjenjë mbështetjeje që zakonisht i mungon, dhe një ndjenjë që po merret seriozisht. Pranimi nuk do të thotë ta inkurajosh, por të dëgjosh dhe të njohësh ndjenjat dhe dëshirat e tij. Pranimi jep mundësinë që të thyhet izolimin social dhe ndihmon fëmijën të përballet me veten.

Nëse krijohet ideja se fëmija po mendon vetëvrasjen duhet që:

- Të identifikoni nëse fëmija ka tentuar më parë vetëvrasje.
- Ta merrni fëmijën seriozisht në çdo kohë dhe të tregoni shqetësimin tuaj të sinqertë.
- Ta lini fëmijën të shprehë ndjenjat e tij/saj, sado i dëshpëruar të jetë ai. Duhet ta pyesni fëmijën se si po mendon të bëjë vetëvrasje, çfarë plani ka. Edhe një herë, kjo i jep fëmijës ndjenjën se ju po e merrni seriozisht. Të flasësh për planin e fëmijës nuk do të rrisë rrezikun, sepse ai e ka menduar tashmë. Të flasësh për planin është të masësh rrezikun - në përgjithësi, sa më precise të jenë planet, aq më i madh është rreziku për vetëvrasje reale.
- Ta pyesni fëmijën arsyen e këtij veprimi dramatik. Përgjigjja do t'ju japë më shumë njohuri për motivet e fëmijës, të cilat ju mund t'i përdorni për të sugjeruar mënyra më pak dramatike për të ndryshuar situatën e caktuar.
- Të përpiqeni të zbuloni se cila ngjarje (është shpesh ajo më e fundit) i ka shkaktuar fëmijës tendencat vetëvrasëse. Kjo i jep mundësi këshilluesit që të kuptojë këndvështrimin e fëmijës për problemin dhe do t'ju japë mundësinë të kuptoni se ku do të fokusoheni. Kjo do të sigurojë një fokus për ju, si këshilltar.
- Të ruani qetësinë gjatë bisedës
- Të bëni një plan për kë do të kontaktojë fëmija nëse ndjehet se do të bëjë vetëvrasje – një plan me të paktën tre kontakte
- Të mos bëni asnjë premtim për ruajtje të konfidencialitetit-ta referoni fëmijën te një psikolog ose psikiatër nëse është e nevojshme nëse ka rrezik aktual për vetëvrasje

Mjete që mund të përdoren gjatë këshillimit

1. Teknikat e vizatimit

- *Vizatimi i ngjarjeve/ ditari me vizatime*. Kjo teknikë konsiston në mbajtjen e një ditari ngjarjesh jo me fjalë por me vizatime. Fëmija mund të zgjedhë të shkruajë komente për figurën që ka zgjedhur. Fëmija vizaton çfarë dëshiron për një ngjarje që dëshiron. Fëmija e sjell ditarin që ta shohë këshilluesi. Këshilluesi e pyet pastaj fëmijën se çfarë përfaqësojnë elementët e vizatimit çfarë kuptimi kanë; Rrjedha e pyetjeve duhet të jetë : me thuaj si u ndjeve kur e vizatove këtë ? Çfarë kishte ndodhur përpara këtij vizatimi çfarë do ndodhë më pas? Çfarë të pëlqen në këtë vizatim? Me thuaj si do ta ndryshojë këtë figurë? Më thuaj cili është morali apo titulli i kësaj figure? Disa figura/ vizatime mund të lidhen së bashku dhe këshilluesi mund t'i kërkojë fëmijës që të



tregojë një histori me fillim mes dhe fund . Nëse vizatimi është abstraksion, këshilluesi mund ta pyesë fëmijën t’i verë një emër ndjenje ngjyrave që ka përdorur. Nganjëherë këshilluesi mundet që të ndajë përshtypjen e tij për vizatimin dhe ta pyesë fëmijën nëse kjo ishte ajo që donte të transmetonte¹⁰

2. Kukullat (për fëmijët me moshë të vogël)

- Kukullat janë një mjet që janë përdorur nga këshilluesit e fëmijëve të shkollës fillore dhe prej terapistëve të tjerë për të ndihmuar fëmijët dhe ndonjëherë adoleshentët dhe të rriturit për të shprehur ndjenjat e tyre, për të rivlerësuar ngjarjet emocionale të së kaluarës dhe për të provuar sjellje të reja. Kukullat përdoren për të zhvilluar gjuhën dhe aftësitë komunikuese, për të kapërcyer izolimin fizik dhe emocional, për të rritur vetëvlerësimin , për inkurajuar lëshimin e emocioneve ,për të marrë vendime , për terapi fizike etj.. Sipas Jeëel, i vetmi kufizim në përdorimin e kukullave është imagjinata e këshilluesit dhe e fëmijës¹¹
- Përdorimi i kukullave për vlerësim përfshin: vënien në dispozicion të disa kukullave dhe observimin se cilën prej tyre do zgjedhë fëmija, kërkimin që fëmija të tregojë një histori nëpërmjet kukullave; luajtjen e pjesës me kukulla nga fëmija; pyetjen e kukullave nga këshilluesi; pyetjen/ intervistimin e fëmijës nga këshilluesi.
- Nëse këshilluesi do të vendosë të përdorë kukullat si mjet në këshillim do t’I duhen rreth 15-20 kukulla që shprehin emocione të ndryshme të një fëmijëe¹² . Në zgjedhjen e kukullave duhet patur kujdes që: të zgjidhen kukulla të cilat janë lehtësisht të manipulueshme prej fëmijës, nuk konsiderohen simbole universale – Babagyshi I Vitit të Ri; mund të mbahen apo vendosen në dorë edhe nga fëmija edhe nga këshilluesi, kukulla që përthyhen dhe nuk janë rixhide, kukulla që mund të lahen mirë; kukulla që kanë karakter , që nxisin imagjinatën e vetë këshilluesit.

¹⁰ Jennifer Birch, M.A. The University of Alabama Karla D. Carmichael, Ph.D. The University of Alabama Using Draëings in Play Therapy: A Jungian Approach, <https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ875395.pdf>

¹¹ Carter, Richard B., Mason, Perry S., The selection and use of puppets in counselling https://www.jstor.org/stable/42731871?read-now=1&seq=2#page_scan_tab_contents

¹² Carter, Richard B., Mason, Perry S., The selection and use of puppets in counselling https://www.jstor.org/stable/42731871?read-now=1&seq=3#page_scan_tab_contents

3. Narrativat

- *Distancimi nga problemi ose nxjerrja jashtë e problemit nëpërmjet narrativës* : Këshilluesi i kërkon fëmijës të shkruajë një histori ku sjellja e agresive ndaj fëmijëve në shkollë ose ndaj prindësrve është “ personazhi i keq”. Qëllimi është që sjeljet e pashëndetshme si mungesa e durimit , agresiviteti etj., të mos konsiderohen më si pjesë e brendshme por si një forcë e jashtme e cila duhet mundur. Nëse fëmija ndjehet fajtor për temperamentin e vet , këshilluesi e ndihmon nëpërmjet kësaj teknike që ta izolojë këtë karakteristikë dhe ta nxjerrë jashtë , të mos jetë më pjesë e fëmijës. Kjo strategji ndihmon rindërtimin e historisë në atë mënyrë që të reduktojë incidencën e problemit, të eliminojë rezultatet negative dhe të përforcojë zhvillimin dhe arritjet personale.
- *Teknika e rezultateve shumë të mira*: Kjo teknikë shpjegohet me analogjinë me një romancier: “ju jeni një romancier. Ju japin një roman për ta rishikuar dhe botuar në mënyrën që ju preferoni. Ju e lexoni dhe e gjeni përgjithësisht të varfër, por ka pasur disa ide interesante që ju pëlqyen. Ju zgjidhni këto ide dhe rishkruani romanin rreth tyre. Ju mund të bëni që një histori me të meta të bëhet bestseller”¹³ Kjo teknikë konsiston në atë që këshilluesi përpiqet të identifikojë rezultatet e jashtëzakonshme pozitive nëse një histori e shkruar nga fëmija është plot me probleme dhe ngjarje negative. Këshilluesi e ndihmon fëmijën në rihvillimin e narrativës me fokus në ato rezultate unike pozitive. Kjo ndihmon fëmijën në fuqizimin e tij/saj duke krijuar një nocion se ato rezultate unike mund të mbizotërojnë mbi problemet.

13 <https://www.aipc.net.au/articles/narrative-therapy/>

ANEKS

I- Fazat e Menaxhimit të Rastit në Nevojë për Mbrojtje sipas VKM 578

Identifikimi

Identifikimi i një fëmijë në nevojë për mbrojtje bëhet nga çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, i cili vihet në kontakt me fëmijën, mësuesit, ofruesit e shërbimit psikosocial shkollor, strukturat e Policisë së Shtetit, Drejtoria për Azilin dhe Antitrafikimin, Qendra Kombëtare e Pritjes për Azilkërkuesit, punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, si dhe vetë fëmijët. NJJMF-të dhe PMF-të kanë për detyrë të kryejnë identifikim proaktiv të fëmijëve në nevojë për

mbrojtje, nëpërmjet planifikimit të punës në terren, verifikimit të njoftimit të marrë nga çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijën, si dhe verifikimit të informacionit për rastet që vijnë në dijeni nëpërmjet medias së shkruar, elektronike apo medias sociale.

Raportimi

Pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, çdo person fizik ose juridik, si dhe çdo punonjës i institucioneve publike e private, i cili vihet në kontakt me fëmijën për shkak të profesionit, duhet të bëjë raportimin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës ose pranë organeve të Policisë së Shtetit. Çdo mësues, ofrues i shërbimit psikosocial shkollor, punonjës i institucioneve shëndetësore apo i përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, duhet të bëjë raportimin pranë njësisë arsimore vendore, drejtorit të institucionit, organeve të Policisë së Shtetit, strukturave për mbrojtjen e fëmijës. Raportimi i fëmijës në nevojë për mbrojtje bëhet me çdo mjet komunikimi, me telefon, *e-mail*, me postë, në formë shkresore, duke kontaktuar punonjësën e strukturave të Policisë së Shtetit apo të strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar është një vlerësim i shpejtë i nivelit të rrezikut, bazuar në informacionin e disponueshëm nga identifikimi ose raportimi, si dhe nga informacioni që mund të merret nga institucionet, organizatat apo persona të tjerë, që kanë dijeni për rastin dhe/ose janë në kontakt me vetë fëmijën. Vlerësimi fillestar kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur, mundësisht brenda 24 orëve dhe, maksimalisht, brenda 48 orëve pas raportimit. PMF-ja, gjatë vlerësimit fillestar, vlerëson: a) Nivelin e rrezikut për një periudhë afatshkurtër, duke mbajtur në konsideratë sigurinë, mbrojtjen fizike, shëndetin e fëmijës dhe nevojën për masë emergjente të mbrojtjes; b) Nevojat bazë, për sa u përket ushqimit, higjienës, strehimit dhe kujdesit shëndetësor; c) Shërbimet e domosdoshme, me qëllim përmbushjen e nevojave të identifikuar në kushtet e emergjencës.

Vlerësimi i plotë

Vlerësimi i plotë kryhet për çdo rast të fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe ka si qëllim të përcaktojë në mënyrë të plotë nivelin e rrezikut, në të cilin ndodhet fëmija, si dhe të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes. PMF-ja, gjatë vlerësimit

të plotë, vlerëson: a) Nivelin e rrezikut në të cilin ndodhet fëmija në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, si dhe faktorët e rrezikut; b) Nevojat e fëmijës në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tij/saj dhe nevojat e familjes; c) Faktorët mbrojtës, në veçanti pikat e forta, kapacitetet dhe burimet e fëmijës, të familjes, nëse është e nevojshme edhe të familjes së gjerë;

Hartimi i Planit Individual të Mbrojtjes

Pas plotësimit të formularit të vlerësimit dhe analizës së rrezikut, PMF-ja harton Projektplanin

Individual të Mbrojtjes, sipas formularit të PIM-it. Projektplani Individual i Mbrojtjes hartohet mbi bazën e nevojave të identifikuar të rastit dhe përmban veprimet, ndërhyrjet dhe shërbimet e nevojshme për të ulur nivelin e rrezikut. PIM-i përmban: a) Listën e nevojave të fëmijës dhe familjes; b) Veprimet apo ndërhyrjet konkrete për aksesin dhe realizimin e të drejtave të fëmijës; c) Shërbimet e nevojshme për të përmbushur nevojat; ç) Vendimin për masën e mbrojtjes; d) Autoritetet dhe aktorët përgjegjës; dh) Afatet kohore; e) Ofruesit e shërbimeve publike dhe jopublike.

Zbatimi, monitorimi dhe rishqyrtimi i PIM-it

Çdo institucion, autoritet apo ofrues shërbimi i përcaktuar në PIM është përgjegjës për realizimin e aktiviteteve, të veprimeve, ndërhyrjeve apo ofrimit të shërbimeve të përcaktuara në PIM për fëmijën, prindërit apo anëtarët e familjes së tij.

Mbyllja e rastit

PMF-ja raporton te GTN-ja për mbylljen e rastit nëse, pas rishqyrtimit të PIM-it, rezulton se:

a) Veprimet, ndërhyrjet e ndërmarra dhe shërbimet e ofruara sipas planit janë kryer, fëmija është jashtë rrezikut dhe nuk ka shqetësime të tjera për fëmijën; b) Individët kanë mbushur moshën 18 vjeç. Nëse PMF-ja vlerëson se fëmija, i cili ka mbushur moshën 18 vjeç, ka ende nevojë për shërbime, rasti do të referohet për marrjen e shërbimeve të përshatshme të strukturat që mbulojnë shërbime për këtë grup-moshë dhe në përputhje me nevojat e individit; c) Fëmija vdes; ç) Fëmija ka ndryshuar vendbanim ose vendqëndrim dhe dosja e tij është transferuar.

II- Këshillimi si pjesë e menaxhimit të rastit

Këshillimi psikosocial si një prej shërbimeve të nevojshme për fëmijën në nevojë për mbrojtje duhet të integrohet në fazat e menaxhimit të rastit të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 578. Figura më poshtë dhe tabela në anekse japin rrjedhën dhe përshkruajnë fazat e menaxhimit të rastit sipas VKM 578.

Figura qendrore e menaxhimit të rastit është Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës (PMF). Këshilluesi psikosocial aktivizohet prej PMF-së dhe është një kontribues dhe bashkëpunëtor i rëndësishëm në të gjitha fazat e menaxhimit të rastit për një kujdes tërësor për fëmijën.

Qoftë gjatë fazës së vlerësimit dhe planifikimit të ndihmës, qoftë gjatë vlerësimit të trajtimit me këshillim Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës dhe Këshilluesi duhet të referojë fëmijën menjëherë te një mjek, një psikiatër apo psikolog i specializuar për të vendosur nëse këshillimi psikosocial, një trajtim tjetër apo trahtime paralele janë të nevojshme në rast se:

- Fëmija ka tentuar apo deklaron se do kryejë vetëvrasje apo është duke dëmtuar veten;
- Është shumë i dhunshëm ndaj të tjerëve;

- Nuk mban mend fakte të thjeshta dhe nuk kryen dot veprimet e rutinës – zgjimin;
- Raporton se ka qenë viktimë e përdhunimit, torturës, dhunës apo ka qenë dëshmitar i ngjarjeve tragjike;
- Raporton se ka përdorur droga dhe sidomos kur nuk kanë patur akses në droga për një kohë të gjatë;
- Raporton gjendje psikiatrike të mëparshme.

Për të pasur një këshillim efektiv dhe të dobishëm, agjencia në të cilën vepron këshilluesi dhe vetë këshilluesi, përveçse me PMF-në, duhet të vendosë lidhje dhe aleanca me organizata, shërbime dhe individë të tjerë. Këshilluesi duhet të punojë sidomos me:

- familjen e fëmijës, shkollën, klubin etj., të gjithë që kanë një rol dhe kujdesen për fëmijën. Këta agentë social mund të reduktojnë rreziqet për riviktimizim dhe stigmatizim të fëmijës.
- psikiatrit dhe psikologët për të vlerësuar, diagnostikuar dhe trajtuar fëmijën;
- mjekët, klinikat dhe spitalet të cilët bëjnë konsulta dhe trajtime për shëndetin fizik dhe ofrojnë shërbime mjeko- ligjore;
- drejtuesit e shkollave dhe mësuesit të cilët mund të ndihmojnë lidhur me vështirësitë që kanë fëmijët në shkollë;
- policinë dhe agjensitë e sigurisë që ruajnë fëmijët gjatë aktiviteteve;

organizatat që japin ndihmë për profesionistët dhe për fëmijët në rrethana shumë të vështira

Fazat e Këshillimit Psikosocial

Fazat e këshillimit si pjesë e punës në ekip për menaxhimin e rastit janë: 1. identifikimi, 2. Fillimi/ vendosja e raportit, 3. përcaktimi i problemit, 4, vendosja e qëllimeve; 5. zbatimi i planit / arritja e qëllimeve; 6. mbyllja e procesit të këshillimit; 7. ndjekja pas këshillimit

Faza 1. Identifikimi i fëmijëve që mund të ndihmohen nga këshillimi psikosocial (screening).

Identifikimi duhet të përfshijë minimalisht:

- a) Informimin proaktiv të të drejtave të fëmijës dhe shërbimit të mbrojtjes;
- b) Vlerësimin tërësor të situatës së fëmijës dhe potencialit të shërbimeve përfshirë nevojën për këshillim psikosocial;
- c) Informimin dhe lejen për këshillim psiko-social;
- d) Përgatitjen e këshilluesit dhe partnerëve të ndihmës për ndihmën në tërësi dhe këshillimin;

a) Informimi proaktiv për të drejtat dhe shërbimet e mbrojtjes

Informimi për të drejtat mund të bëhet në kuadrin e veprimtarisë së Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve ose në kuadrin e aktiviteteve të një organizate që vepron në zonë

b) *Vlerësimi tërësor i situatës së fëmijës dhe potencialit të shërbimeve përfshirë nevojën për këshillim psikosocial.*

Në vlerësimin e nevojave duhen patur parasysh shenjat e stresit psikologjik që janë : të ndjerët keq dhe qarja, agresiviteti, kthimi në sjellje të cilat i përkasin një moshe më të re, mungesa e interesit, mosfjetja , mosngrënia , mungesa e komunikimit dhe përgjigjes; të ndjerët pa ndihmë , pa shpresë. ¹⁴ Në këtë fazë duhet të përcaktohet nëse fëmija do të ndihmohet në familje apo duhet t'i caktohet një kujdestar tjetër ¹⁵

c) *Informimi dhe leja për këshillim psiko-social*

Informimi për këshillimin psikosocial duhet të përmbajë minimalisht: referencat ligjore për shërbimin, detyrimin ligjor për raportimin , cilat janë qëllimet e këshillimit, cili do të jetë autoriteti që do ta kontrollojë këshillimin, cilat do të jenë masat që do të merren për ruajtjen e konfidencialitetit dhe privatësisë , kush janë personat që do të informohen për progresin, cili është dokumentacioni që do të mbahet dhe si do të ruhet ai, si do të zhvillohen seancat, sa do të zgjasin ato, si do të raportohet për progresin , kush do të duhet të marrë pjesë në seancat e këshillimit psikosocial.

Nëse fëmija, këshilluesi dhe prindërit shprehin motivimin ose nevojën për të filluar këshillimin, atëherë mund të nisë këshillimi.¹⁶

Faza 2 Fillimi i procesit të këshillimit / ndërtimi i raportit

Faza e krijimit të raportit mund të marrë minuta por edhe orë, varet nga personaliteti i fëmijës dhe problemet që ka.

Çfarë përfshin kjo fazë/ çfarë qëllimi ka ?

Kjo fazë përfshin: a) ta bësh fëmijën të ndjehet i sigurt ; b) të krijosh një raport / marrëdhënie me fëmijën; d) të informosh dhe të sigurohesh që fëmija kupton se çfarë do të ndodhë në ambjentin e këshillimit dhe jashtë tij/saj c) të vlerësosh nevojën për të bërë referimin dhe të referosh. d) të rrisësh motivimin për pjesëmarrje aktive në procesin e këshillimit; e) të rrisësh ndjenjën e besimit tek këshilluesi dhe kontrollit të fëmijës mbi atë që po ndodh

Për të arritur këto qëllime , këshilluesi duhet që:

Për të bërë fëmijën që të ndjehet i sigurt

- Të rregullojë të takojë fëmijën në një vend që është privat, komfort dhe pa shqetësime për fëmijën dhe për kujdestarët, familjen e tij/saj;
- Të jetë i kujdesshëm me mënyrën e qëndrimit, veshjen, tonin e zërit, reagimet empatike;
- Të mos fillojë direkt me pyetje - Fëmija duhet lënë të ambjentohet, t'i ofrohet ndonjë pije freskuese apo e ngrohtë, biskota, të pyetet si erdhi në takim etj..

Për të krijuar një raport / marrëdhënie me fëmijën

- Fëmijës duhet me iu drejtu me emrin që dëshiron;
- Të përdoret kreativiteti i përshtatshëm për moshën e fëmijës. Të përdoren mënyra të ndryshme loje me të cilat fëmija është mësuar, p.sh një lojë me pyetje dhe përgjigje;

¹⁴ Ka një seksion të formatit të vlerësimit aneksi 6 formulari i vlerësimit dhe analiza e rrezikut të quajtur “çështje psikologjike”

¹⁵ Do të përcaktohet masa e mbrojtjes që do të jetë edhe largimi nga familja- masa alternative e mbrojtjes

¹⁶ Në aneks një model i lejes së informuat për këshillim

- Të flitet me fëmijën për gjërat që i interesojnë, shokët, hobet, filmat , lagjen etj.;
- T'i thuhet fëmijës diçka rreth vetes, t'i shpjegohet çfarë është këshilluesi çfarë do të thotë këshillim;
- Fëmijës t'i thuhet që këshilluesi është i shqetësuar dhe i interesuar për të dhe e respekton atë;
- Gjatë komunikimit duhet me qenë i ngrohtë dhe ftues kundrejt fëmijës dhe t'i kushtohet vëmendje normave dhe nevojave sociale të fëmijës;
- Gjatë komunikimit duhet të kërkohet për shenja që tregojnë stilin e preferuar të komunikimit dhe identitetin kulturor. Duhet të modifikohet stili i komunikimit apo përgjigjes së këshilluesit, nëse është e nevojshme;

Për t'u siguruar që fëmija kupton se çfarë ndodh dhe do të ndodhë në ambjentin e këshillimit dhe jashtë tij/ saj

- Fëmijës i shpjegohet se një seancë këshillimi zgjat për një kohë të caktuar por mund të zgjatet me marrëveshje të ndërsjellë- këshillimi për fëmijët duhet të zgjasë të paktën 30 minuta, por nuk duhet të kalojë një orë e gjysmë;
- Fëmijës i shpjegohet se këshillimi është përgjegjësi edhe e këshilluesit dhe e fëmijës prandaj ai/ajo ka të drejtë të caktojë një takim dhe ta anulojë atë;
- Afër fundit të seancës fëmijës i thuhet se po afrohet fundi dhe se mund të sjellë çështje që i mendon si të rëndësishme;
- Fëmijës i shpjegohet se ndërmjet seancave, këshilluesi mund ta kontaktojë atë direkt për t'u siguruar që është mirë , që po i bën detyrat që ka marrë përsipër etj.;
- Fëmijës i shpjegohet se në cilat situata ai/ajo nuk do të presë seancën e rradhës por do të kontaktojë menjëherë këshilluesin, punonjësën e mbrojtjes së fëmijës, ndihmën e shpejtë/ urgjencën etj..

Për të vlerësuar nevojën për të bërë referimin dhe referimi në shërbime të nevojshme , gjatë fazës për vendosjen e raportit, duhet që:

- Të vëzhgojë me kujdes dhe të pyesë fëmijën për shenja që fëmija ka nevoja bazë të paplotësuara – veshjen , ushqimin, higjenën;
- Të komunikojë me prindin/ kujdestarin lidhur me vëzhgimet e veta;
- Të informojë prindin/ kujdestarin për raportimin që do të bëjë lidhur me këto nevoja;
- Të referojë – të shoqërojë fëmijën , prindin në agjenci , organizata të ndryshme publike dhe jopublike nëse kjo kërkohet nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës;

Për të rritur motivimin për pjesëmarrje aktive në procesin e këshillimit

- Fëmijës i jepet një “ detyrë shtëpie” që duhet të shërbejë si lidhëse me seancën tjetër;
- Fëmija inkurajohet të flasë lirisht me të tjerët lidhur se çfarë ka ndodhur në seancën/ seancat e kësaj faze;
- Fëmija inkurajohet të ftojë personat e vet të besuar të komunikojnë me këshilluesin lidhur me qëllimet e komunikimit dhe ndihmën që ata i japin fëmijës

Për të rritur ndjenjën e besimit tek këshilluesi dhe kontrollit të fëmijës mbi atë që po ndodh

- Fëmijës i kërkohet leje që këshilluesi të flasë me mësuesin , prindërit , të tjerët lidhur me fëmijën edhe veçmas edhe me prezencën e fëmijës;

Ndërfazat

Mes sesioneve të vendosjes së marrëdhënies dhe fazës së vlerësimit dhe përgjithësisht mes sesioneve , mund të zhvillohen aktivitete që ndihmojnë sesionet pasardhëse . Të tilla mund të jenë

- Këshilluesi krijon një plan për t'ja ofruar fëmijës për të zgjedhur për tu fokusuar gjatë seancës pasardhëse;
- Këshilluesi dhe fëmija bëjnë detyra të caktuara gjatë seancës paraardhëse- fëmija p.sh sugjerohet të shkruajë në një ditar. Këto detyra në fillim duhet të jenë të thjeshta që fëmija t'i kryejë dhe ta ndjejë veten të suksesshëm dhe të vlefshëm.
- Seanca pasardhëse fillon me detyrën e fëmijë- është detyra e këshilluesit ta përgëzojë për detyrën e kryer;

Faza 3 Vlerësimi – Identifikimi i problemeve

Çfarë përfshtin kjo fazë/ çfarë qëllimi ka?

Qëllimet e fazës janë që: a) Këshilluesi të krijojë një ide të qartë për fëmijën si një individ në total, pikat e forta dhe të dobëta të tij , aftësinë e tij për t'u shëruar dhe karakteristika të tjera; b) Këshilluesi të krijojë një ide të qartë se si funksionon fëmija aktualisht; c) Fëmija të kujtojë se çfarë është e rëndësishme të bëjë për të ndryshuar situatën d) këshilluesi dhe fëmija të jenë në gjendje të formulojnë një plan ndërhyrjeje e) të ruhet motivimi për pjesëmarrje aktive në procesin e këshillimit

Për të krijuar një ide të qartë për fëmijën si një individ në total, pikat e forta dhe të dobëta të tij, aftësinë e tij për t'u shëruar dhe karakteristika të tjera, këshilluesi duhet që:

- Të evitojë tingëllimin sikur “po e merr në pyetje“fëmijën;
- Të mbledhë informacion mbi situatat që fëmija i percepton problematike dhe karakteristikat e këtyre situatave. P.sh: Kur inatosesh? Kur je inatosur x rradhë kush ishte present? Kur ke frikë? Sa shpesh të ndodh që të kesh frikë?
- Të mbledhë informacion mbi efektin e situatave apo sjelljeve të tjerëve mbi fëmijën apo të tjerët. P.sh. Si u ndjeve kur nëna..
- Në momentin e përshtatshëm të ndihmojë fëmijën që të kujtojë situata që kanë ndikuar shumë në situatën aktuale duke mbledhur informacion mbi : situata negative dhe të lumtura të jetës, ndjenjat për secilën situatë, reaksionin dhe përballimin e situatës nga fëmija, rrethin shoqëror që e ndihmoi me ndjenjat dhe sjelljen e tij;
- Të përcaktojë dhe të vlerësojë se si fëmija mbijetoi dhe funksionoi pas krizës problematike apo problemeve të mëparshme në jetën e tij/saj- të identifikojë strategjitë e përballimit të fëmijës dhe efektin e tyre;

Për të krijuar një ide të qartë se si funksionon fëmija aktualisht, këshilluesi duhet që:

- Të pyesë fëmijën mbi efektin që situatat e mëparshme kanë në jetën e tanishme të fëmijës;
- Të vëzhgojë për sjellje që tregojnë nivelin e keqpërshtatjes;

Për ta ndihmuar fëmijën të kuptojë se çfarë është e rëndësishme të bëjë për të ndryshuar situatën

- Të pyesë fëmijën lidhur me përpjekjet që ai bën për të ndryshuar sjelljen e tij;
- T'i vërë në dukje fëmijës aftësitë e tij fizike intelektuale emocionale , motivimin e tij , dhe potencialin për të përmirësuar situatën aktuale
- Të pyesë fëmijën se çfarë do që të bëjë lidhur me situatën , problemin , kush janë njerëzit që do ta ndihmojnë ta zgjidhë;
- Të kujtojë fëmijën që këshilluesi do ta mbështesë;
- Të ndihmojë fëmijën të ketë besim në forcat e veta;

Për të ruajtur motivimin për pjesëmarrje aktive në procesin e këshillimit

- Gjatë seancave gjithmonë bëhet një përmbledhje e çfarë ka ndodhur, e aktiviteteve të zhvilluara, dhe sa e kanë ndihmuar ato fëmijën të arrijë qëllimet e vendosura;
- Vetë fëmija dhe bashkëpunëtorët duhet të ndërjegjësohen/ informohen se arritja e qëllimeve varet shumë nga aftësia e fëmijës për të diskutuar hapur mendimet dhe ndjenjat e tij me ju;
- Këshilluesi nuk duhet të japë këshilla : fokusi i këshillimit është të ndihmojë fëmijën që të përdorë burimet e veta të brendshme dhe të jashtme dhe jo të japë zgjidhje të menjëhershme apo këshilla

Faza 4 Formulimi i qëllimeve në këshillim – hartimi i planeve të ndihmës

Qëllimet e kësaj faze janë që: a) të vendosen qëllime të cilat janë të lidhura me problemin e identifikuar nga fëmija dhe atë që do të arrijë fëmija; b) të vendosen qëllime të cilat janë të arritshme nga këshillimi psikosocial; c) të përgatisë fëmijën për aktivitetet e fazës tjetër , zgjidhjes së shqetësimeve dhe problemeve

Pë të vendosur qëllime të cilat janë të lidhura me problemin e identifikuar nga fëmija dhe atë që do të arrijë fëmija duhet që:

- Këshilluesi të punojë me fëmijën për të përcaktuar objektivat e këshillimit. Së bashku me fëmijën duhet vrarë mendja (brainstorming) për: cilat janë qëllimet , ku duam të arrijmë, si do arrijmë aty?
- Të mos rrëzohet asnjë objektiv i fëmijës duke dhënë zgjidhje të atypëratyshme;
- Të vendoset se cilat janë çështjet kryesore që duhet të zgjidhen- dua që mamaja të mos më bërtasë më; dua që vëllai i madh të mos tallet me mua;
- Këshilluesi duhet të kuptojë qëllimet edhe kur ato nuk artikulohen qartaz si të tilla nga fëmijët- fëmija mund të mos thotë se çfarë do pikërisht por ka dhënë indice për nevojën që ka të mos përjetojë më ndjenja dhe ragime si: izolimi dhe depresioni pas abuzimit; vetëvrasje pas abuzimit seksual; depression dhe inat / urrejtje pas keqtrajtimit nga babai , mungesën e besimit tek të tjerët.

Për të vendosur qëllime të cilat janë të arritshme nga këshillimi psikosocial duhet që:

- Këshilluesi të rivizitojë së bashku me fëmijën Planin Individual të Mbrojtjes;
- Fëmija duhet të përfshihet në vendimin nëse ka persona të tjerë përveç këshilluesit që mund të marrin pjesë në këshillim si mësuesit, bashkëmoshatarët, psikologu, psikiatri, pasi fëmijës i është shpjeguar qëllimi specifik për të cilin këta njerëz do marrin pjesë në këshillim;
- Qëllimet duhet të fokusohen në situata ose sjellje specifike që duhen ndryshuar dhe duhet të jetë realiste dhe konkrete, si p.sh.: menaxhimi i zemërimit ndaj babait; përmirësimi i marrëdhënieve me bashkëmoshatarët ose prindërit ; menaxhimi i inatit; rritja e vetëbesimit; mundja e ndjenjave të fajit dhe tregimi të prindërit për abuzimin e pësuar; zgjidhja e konflikteve me njerëz të tjerë; rifitimi i shpresës për të ardhmen pasi fëmija ka qenë në prostitucion;

Për të përgatitur fëmijën për aktivitetet e fazës tjetër , zgjidhjes së shqetësimeve dhe problemeve

- Fëmija duhet të informohet se Këshilluesi do të mbajë të përditësuar Punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijës për qëllimet e vendosura, progresin e bërë dhe do t'i kërkojë masa të tjera shtesë apo ndihmë shtesë nëse është e nevojshme për progresin e fëmijës;
- Fëmijës do t'i shpjegohen metodat që mund të përdoren për zgjidhjen e problemeve;
- Fëmijës do t'i lihet një detyrë për sesionin e ardhshëm;

Faza 5 Zbatimi i qëllimeve të këshillimit- zgjidhja e problemeve

Qëllimi i kësaj faze është që të vihet në zbatim ajo që është planifikuar së bashku me fëmijën. Ky qëllim ndahet në: a) identifikimin e metodave të zgjidhjes së problemeve; b) hartimin e një plani të detajuar; c) aplikimin e zgjidhjeve d) referimin

Për identifikimin e metodave të zgjidhjes së problemeve duhet që

- Këshilluesi të informojë për metoda të zgjidhjes së shqetësimeve- e folura-dëgjimi; lojrat; ushtrimet e frymëmarrjes ; vizatimet; ditari; relaksimi; drama etj.;
- Këshilluesi dhe fëmija diskutojnë për avantazhet dhe disavantazhet e secilës metode;

Për hartimin e një plani të detajuar duhet që

- Këshilluesi të shkruajë: Problemin apo problemet që duhen zgjidhur; qëllimin dhe qëllimet e objektivat , hapat që do të ndiqen

Për aplikimin e zgjidhjeve duhet që;

- Këshilluesi të koordinojë përfshirjen e fëmijës në aktivitete jashtë – aktivitete sociale, lojra;
- Gjatë gjithë fazës së aplikimit këshilluesi duhet të verifikojë se si po e ndihmojnë aktivitetet e zhvilluara fëmijën dhe si po ndihmojnë ato arritjen e qëllimeve të vendosura;

- Këshilluesi duhet të jetë informues dhe mbështetës për fëmijën që ka vështirësi të kuptojë situatën dhe të arrijë qëllimin e vënë;
- Duhet të ndryshohen qëllimet nëse fëmija ndjen se nuk arrin dot ose kur ndodhin probleme të tjera dhe ndjenja e sjellje të reja duhet të adresohen më parë;
- Këshilluesi duhet të jetë një model për fëmijën për sa i përket durimit, kujdesit dhe kryerjes së detyrave- kjo i tregon fëmijës që procesi i këshillimit është përgjegjësi dypalëshe

Për referimin duhet që

- Këshilluesi duhet të njohë dhe të jetë në gjendje të informojë fëmijën për shërbime të tjera që janë të nevojshme për të.¹⁷

Faza 6 Mbyllja e Procesit të Këshillimit

Qëllimet e veprimeve të kësaj faze është që: a) të sigurohet që këshillimi ka qenë i dobishëm për fëmijën dhe është zhvilluar me vullnetin e tij ; b) fëmija të jetë i informuar për shërbimet pas këshillimit

Për të siguruar që këshillimi ka qenë i dobishëm për fëmijën dhe është zhvilluar me vullnetin e tij duhet që

- Këshilluesi dhe fëmija bien dakord që sesionet të mbyllen sepse janë arritur qëllimet e vendosura më parë dhe sjellja e dëshiruar është ngulitur e po ndodh në jetën e përditshme;
- Kur fëmija vendos të ndërpresë seancat e këshillimit, dhe këshilluesi mendon se kjo është e parakohshme, këshilluesi eksploron arsyet e fëmijës;
- Sesionet të mbyllen kur fëmija jep shenja që është gati të përfundojë këshillimin sepse kushtet në jetën e tij kanë ndryshuar / janë përmirësuar dhe fëmija nuk i ka më ato ndjenja negative;
- Këshillimi mbyllet kur nuk arrihen ndryshimet e dëshiruara;

Faza 7 Ndjekja pas Këshillimit

Qëllimet e veprimeve të kësaj faze janë që: a) të sigurohet që situata nuk përsëritet pasi është përfunduar këshillimi; b) fëmijës t'i jepet ndihma e duhur ose të referohet

Faza është ndërtuar mbi pranimin se sado e suksesshme të ketë qenë ndërhyrja ajo nuk garanton situata nuk do të vazhdojë pasi këshillimi të ndërpritet. Veprimet e kësaj faze mund të jenë : vizita tek fëmija ose ftesa që fëmija të vizitojë këshilluesin, kërkesa që fëmija të plotësojë një pyetsor e t'ja dërgojë këshilluesit. Këto duhet të ndodhin në mënyrë të rregullt me një shpeshësi të rënë dakord me fëmijën, prindin/ kujdestarin dhe PMF-në.

¹⁷Sipas UNICEF, shumë kohë pas krizës, një pjesë e vogël e fëmijëve mund të ketë nevojë për ndërhyrje profesionale psikologjike dhe kjo ndërhyrje është përtej mbështetjes psikosociale <https://bettercarenetwork.org/sites/default/files/attachments/Programming%20for%20Psychosocial%20Support%20FAQs.pdf>

III- Disa sugjerime për parandalimin e rasteve të dhunës në shkollë e jashtë saj²

Për parandalimin e dhunës në shkollë nga ana e shtetit nevojiten marrja e një sërë masash si:

- 1- Bashkëpunimi institucional me organizatat e shoqërisë civile në trajnimin e personelit mësimor.
- 2- Hartimi i studimeve kombëtare mbi eliminimin e dhunës në Institucionin Arsimor
- 3- Hartimi i një plani Kombëtar afatgjatë për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në Institucionin Arsimor.
- 4- Përgatitja e planeve të veprimit nga çdo institucion arsimor në bashkëpunim me organizmat e shkollës, prindër, përfaqësues të komunitetit etj. *Planet e veprimit të mbështeten në Fushat e Standardeve të Shkollës si Qendër Komunitare.*
- 5- Organizimi dhe realizimi i veprimtarive jashtëshkollore me nxënës, mësues, prindër etj. në ditë caktuar, si: 10 Shkurti - Dita e internetit të sigurt, për mbrojtjen e fëmijëve nga ajo që quhet dhunë virtuale (online bullying, online abuse, online sexual abuse, etc.); 12 Qershori - Dita kundër punës së fëmijëve; 2 Tetori - Dita kundër dhunës; 18 Tetor- Dita Evropiane kundër Trafikimit; 19 Nëntori - Dita kundër dhunës ndaj fëmijëve; 20 Nëntori - Dita ndërkombëtare e të drejtave të fëmijëve; 30 korriku dita ndërkombëtare kundër trafikimit; etj. Krijimi i evidencave dhe raportimeve periodike për evidentimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës.
- 6- Përgatitja e rregulloreve të shkollës me kontributin e strukturave vendimmarrëse në shkollë si Qeveri Nxënësish, shërbimi psiko-social dhe bordi shkollës dhe kodeve të sjelljes në shkollë me fokus parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës.
- 7- Komisioni i Etikës dhe i Sjelljes duhet të raportojë rregullisht për numrin e rasteve të cilat kanë shqyrtuar dhe si janë zgjidhur apo çfarë masash janë marrë, DAR/ZA duhet të monitorojë dhe të ketë të dhëna apo raporte të rregullta që shkollë prodhon mbi këto raste dhe për zbatueshmërinë e rregullores së shkollës.
- 8- Takime me përfaqësues të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë e Brendshme, Ministria e shëndetësisë dhe institucioneve të tjera për mbrojtjen e nxënësve nga dhuna në shkollë.
- 9- Fushata ndërgjegjësimi i të gjithë aktorëve për parandalimin e dhunës në shkollë dhe eliminimin e formave të saj.
- 10- Krijimi i *eb-ve dhe komunikimi përmes rrjeteve për shkëmbimin e përvojave dhe identifikimin e rasteve të dhunës.
- 11- Organizimi i takimeve të thirrura nga Drejtoria e Shkollës (forumeve) me nxënës, mësues, prindër, psikologë/punonjës socialë, përfaqësues të njësisë të mbrojtjes së fëmijëve etj. për tematika të ndryshme që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, dhunën, zgjidhjen e konflikteve etj.
- 12- Mbështetja e nismave të fëmijëve apo komunitetit të prindërve për fushata apo aktivitete që promovojnë ndalimin e çdo lloj dhune në institucionet arsimore
- 13- Të ftohen në emisione, apo spote të shkurtra publicitare deputet dhe politikan që flasin dhe promovojnë vlera për eliminimin e dhunës në institucionin arsimor.

- 14- Trajnime rajonale me stafet e institucioneve arsimore dhe anëtarëve të organizmave të shkollës, prindër, përfaqësues të komuniteti në lidhje me legjislacionin, format e dhunës, strategjitë dhe programet e parandalimit.
- 15- Hartimi dhe zhvillimi i materialeve në ndihmë të mësuesve, nxënësve dhe aktorëve të tjerë;
- 16- Krijimi i rrjeteve (grup shkollat) mes institucioneve arsimore për të shkëmbyer eksperiencat pozitive në lidhje me parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës

IV- **Kontakte të Organizatave dhe Strehave dhe Linjave Ndihmëse për viktimat e dhunës në familje**

Tiranë:

QENDRA PËR TË DREJTAT E FEMIJEVE NE SHQIPËRI

RRUGA VASO PASHA ND. 17,
TIRANË, SHQIPËRI

+355675002025

CRCA@CRCA.AL

RRJETI KUNDËR DHUNËS GJINORE DHE TRAFIKIMIT

(4) 2233408

TIRANË

QENDRA FOKUS “NE NDIHME TE FEMIJEVE”

RRUGA ISLAM ALLAM PALL. APT.72, SHK.1, APT. 7
TIRANË

TEL.: 0682068270

E-MAIL: KPILIKA@YAHOO.COM

LINJA KOMBETARE PËR GRA DHE VAJZA

ADRESA: RR. “SAMI FRASHËRI”, PALL.9, SHK.5,
KUTIA POSTARE 2416/1

TIRANË

TEL.: 04 2 233408

E-MAIL: QKGV@ALBNET.NET

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Adresa: Rr. "Vaso Pasha", Pall.12, Shk.1, Ap.1,

Tiranë

TEL./FAKS: 04 2 259795

E-MAIL: AVOKATORE@ALBMAIL.COM AURBOZ@YAHOO.COM

QENDRA ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM

ADRESA: RR. ABDYL FRASHËRI, PALL 10

TIRANË

TEL./FAKS: 04 2 255514

E-MAIL: GADC@GADC.ORG.AL

SHOQATA E GRAVE ME PROBLEME SOCIALE

ADRESA: LAGJJA 11, RR. "BAKI ÇELMETA" (PRANË RESTORANTIT
"PRANVERA"), DURRES

TEL./FAKS: 052 2 223815

E-MAIL: SHOQATAEGRAVE@YAHOO.COM

DURRES

TË NDRYSHËM DHE TË BARABARTË

ADRESA: RR. MILTO TUTULANI, PALL. ALB-MILENIUM, SHK. 6, AP.30-34

TEL.: 04 2221892

E-MAIL: DIFFERENT&EQUAL@ICC-AL.ORG

DURRËS

REFERENCA

Counselling Strategies for Specific Cases and Situations of CEDC

General Manual on Counselling for CEDC <http://docplayer.net/41792991-General-manual-on-psychosocial-counselling-for-children-in-especially-difficult-circumstances-third-edition.html>

Directive (EU) 2017/541 of the European Parliament and of the Council of 15 march 2017 on Combating Terrorism and Replacing Council Framework Decision 2002/475/JHA and Amending Council Decision 2005/671/JHA

WHO, Preventing Suicide – A Guide for Counsellors http://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/43487/9241594314_eng.pdf;jsessionid=FAD00C034FC2E74CAFF22779B789DA3E?sequence=1

RAN, The role of police officers in dealing with jihadist returnees Introduction https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files/2020-09/ran_pol_role_of_police_officers_dusseldorf_30-31_03_2017_en.pdf

IOM, A Psychosocial Approach to Reintegration Counselling. Adapted for the East and the Horn of Africa Region, January 2020, <https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/reintegration-counselling-hoa.pdf>

Using Drawings in Play Therapy: A Jungian Approach Jennifer Birch, M.A. The University of Alabama
Karla D. Carmichael, Ph.D. The University of Alabama, <https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ875395.pdf>

<https://intuitivecreativity.typepad.com/expressiveartinspirations/100-art-therapy-exercises.html>



MANUAL TRAJNIMI

DHUNA TEK FËMIJËT DHE TË RINJTË,
NDIKIMI I RRJETEVE SOCIALE
NE GJENERIMIN E SAJ

*Për mësuesit dhe Profesionistët
e Shërbimeve psiko-sociale në shkolla*